

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7471 E shtunë 17 Mars 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Një ceremoni përkujtimore në Teheran për të përkujtuar poetin e njohur shqiptar Naim Frashëri (1846-1900), e transmetuar në median shtetërore ...
Vijon në faqen 20

Nga STRUAN STEVENSON

**Konspiracion kundër
muhahedinëve iranianë**



Opinion i Ditës

Jemi të 20-ët nga fundi në botë për korrupsion, por ky lajm i zi duket se nuk përbën më ndonjë shqetësim në Shqipëri. Timonieri ynë vazhdon të mburret për ...
Vijon në faqen 21

Nga ASTRIT PATOZI

**Pse nuk përbën më lajm
korrupsioni i Edi Ramës?**



Krimet e Rënda: Burg për 21-vjeçaren

Nusja helmoi vjehtërrën, imami: Nuk denoncova se nuk ma lejon feja

Marjana Cmeta rrefeu krimin dhe Hysen Shehu e regjistroi në video: Erdhi bashkë me familjarët

Nga INA ALLKANJARI

Glykata e Krimeve të Rënda ka caktuar ditën e djeshme ma-sën e sigurisë 'arrest me burg' për 21-vjeçaren Marjana Cmeta, e cila akuzohet se helmoi vjehtërrën e saj me fostoksinë, një vit më parë. Në burg do të qëndrojnë

Në faqen 9

SKEMA/ SI U TJETERSUAN 235 MIJE METRA KATRORE BREGDET TEK 'RANA E HEDHUN'

ABUZIMI ME PRONAT, PRANGA KRYEBASHKIAKUT TE LEZHES

Operacioni "Ranishtja 4", arrestohet Fran Frrokaj dhe 11 zyrtarë të tjerë. 11 zyrtarë dhe përfitues të tjerë në kërkim. Akuza, shpërdorim e falsifikim



(Në foto) Kryetari i bashkisë së Lezhës, Fran Frrokaj. Nënkryetari i Bashkisë së Lezhës, Enver Hafizi

Në faqen 2-3

"20 SHKURTI"

**Viktimat e
komunizmit, PD
tërhiqet nga nisma
për një datë të re**

Në faqen 4

DEBITORET E MEDHENJ

**Borxhi i shtetit
ndaj OSHEE-së
kap shifër rekord,
73 miliardë lekë**

Në faqen 7

PROTESTA

**Cirkut i hiqet
statusi kombëtar?**

**Artistët: Hyjmë
në grevë urie**

Në faqen 12

ARSIMI I LARTE

**Bursa në Itali
për studentët
e Universitetit
të Tiranës**

Në faqen 10



Flet modelja, mbesa e ish-presidentit: Më pëlqen të krijoj familje para së të mbush 30 vjeç

Beniada Nishani: Jam e dashuruar, por ai është xheloz

Në brendësi: Aksidenti, ish-fituesi i "Big Brother" përfundon në karrige me rrota

Nga PAMELA ALIAJ

Prej kohësh ke nisur botën e modelingut. Me çfarë projekti jeni duke u marrë tani? Në këtë moment, projekti im më i rëndësishëm është të çoj deri në fund rrugën e nisur lidhur me studimet për aktrim. Është një

gjë shumë impenjative, që më merr shumë kohë për projektet e tjera. Cila revistë ju ka propozuar për kopertinë? Sa ka qenë shifra më joshëse? Si plan, pas filmimit në të cilin mora pjesë, kam shumë propozime dhe bashkëpunime për të ardhmen. Mbase edhe revista "Play Boy",



do ta vlerësoj si mundësi së bashku me agjencinë time. A ka të dashur Beniada? Nëse po, a është xheloz ai për profesionin tuaj? Në këtë moment në jetën time është një person, i cili është xheloz për mua, aq sa jam edhe unë për të. Xhelozia ...

Suplement

PRONAT ARRESTIMET

SEKUESTRIMI

Pas arrestimit të kryebashkiakut të Lezhës dhe të zyrtarëve të tjerë, me urdhër të prokurorisë, në vendin e quajtur "Rana e hedhun" janë sekuestruar 5 parcela tokë me një sipërfaqe prej 258 324 m². Ashtu si në Kavajë, edhe në Lezhë ka ndodhur e njëjta skemë abuzimi me pronat, duke falsifikuar dokumentet dhe kthyer tokat ranishte në toka bujqësore me pronar dhe mbi to ndërtoheshin biznese të ndryshme, lokale, hotele dhe shtëpi banimi.



Një muaj më parë ministri Xhafaj paralajmëroi arrestime për abuzimet me pronën publike

LEZHË - Arrestimin e kryetarit të Bashkisë së Lezhës, Fran Frrokaj, të akuzuar për "shpërdorim detyre" e paralajmëroi pak kohë më parë ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Ai deklaroi më 15 shkurt të këtij viti se do të kishte arrestime lidhur me abuzimin dhe tjetërsimin e pronave. Ndërsa, më 17 shkurt nga qyteti i Lezhës, Xhafaj tha se shumë shpejt përgjegjësit do të dilnin para drejtësisë. "Dua t'ju them që jam i shqetësuar, u thashë edhe njerëzve të poli-

cisë për disa abuzime që janë bërë me tokat këtu, me pronën publike, me vijën bregdetare në zonën e Lezhës posaçërisht. Besoj që hetimet që janë duke u zhvilluar do të jenë eficiente, do të jenë të suksesshme. Janë hetime që po bëhen bashkë me prokurorinë këtu dhe me Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Unë shpresoj dhe besoj fort që shkaktarët e kësaj batardie do të vendosen përpara përgjegjësisë penale", tha në atë kohë Xhafaj.

Përfituesit e paligjshëm kanë tjetërsuar pronësinë, duke e shitur me çmime simbolike

Skandali me pronat në Lezhë, ja skema e tjetërsimit të 234,548 m² tokë

Zyrtarët e bashkisë dhe të qarkut dhanë sipërfaqe ranore për tokë "arë" e "pemëtoare"

LEZHË

Hetimet në lidhje me skandalin e pronave në Lezhë kanë filluar mbi bazën e të dhënave të siguruar nga policia si dhe ankimet e qytetarëve. Në të evidentohet tjetërsimi në kundërshtim me ligjin të disa pasurive shtetërore "ranishte dhe pyll", përgjatë bregut të detit në zonën e plazhit të fshatit Mali i Rencit dhe Mali i Shëngjinit, tek zona e quajtur "Rana e hedhun", si dhe pjesën e malit në shpatin e tij, sipër zonës së quajtur "Rana e hedhun", në njësinë administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë. Nga veprimet hetimore ka rezultuar se përgjatë periudhës 2016-2017, bashkia Lezhë ka dërguar për regjistrim në ZVRPP-në Lezhë dokumentacionin për pajisjen me tokë të shtetasve: Frrok Frroku, Gj.F., N.F., M.F., Z.Gj., N.T., Pjetër Lini (Gjoni), V.Gj. dhe R.M.. Sipas burimeve policore, praktikat dokumentare të dërguara nga Bashkia Lezhë në Zyren Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lezhë, përmbajnë aktin e marrjes së tokës në pronësi, vërtetimet e kufizimeve, konfirmimet e pasurisë, planet e rilevimit, të cilat janë të falsifikuara dhe janë përpiluar në emër të personave, të cilët nuk kanë qenë dhe nuk janë banorë të fshatit Mali i Rencit. Mësohet se nga ana e Bashkisë Lezhë dhe e Këshillit të Qarkut Lezhë, nëpërmjet shkresave përkatëse zyrtare pavarësisht se në realitet janë mal dhe ranishte janë konfirmuar si toka të kategorisë "Arë" dhe "Pemtoare".



Policia e Lezhës në konferencë për shtyp

REAGIMI

Nënkryetarja e bashkisë Lezhë, Alfrida Marku ka reaguar pas arrestimit të kryetarit të Bashkisë Fran Frrokaj dhe zyrtarëve të tjerë, të cilët akuzohen për shpërdorim detyre. Në një deklaratë për mediat, ajo tha: "Politikisht, kryeministri kriminal, kriminelët e tij në Lezhë dhe kriminelët që e duan Lezhën pa kundërshtarë, do ta marrin përgjigjen sa herë të përballen në Lezhë dhe me qytetarët e saj të ndershëm".

SKEMA E ABUZIMIT

Drejtuesit e Bashkisë Lezhë, duke i paraqitur si tokë bujqësore, kanë dërguar edhe një vendim të falsifikuar në emër të Këshillit të Qarkut Lezhë, si dhe personat e sipërcituar përveçsues të këtyre pronave, janë trajtuar me parë me tokë sipas ligjit 7051 dhe disa nuk janë banorë të zonës. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Lezhë, pasi ka administruar dokumentacionin, gjatë analizimit të dokumentacionit të pajisjes me tokë të shtetasve të sipërcituar, ka konstatuar se sipërfaqet e pasurive nuk janë tokë

bujqësore, por janë tokë pyll dhe ranishte. ZVRPP-ja ka kërkuar konfirmim për dokumentacionin e dërguar nga Bashkia Lezhë, me shkresa përkatëse nga Bashkia dhe Këshilli i Qarkut Lezhë. Bashkia dhe Këshilli i Qarkut Lezhë, i kanë kthyer përgjigje zyrtare ZVRPP-së Lezhë, ku rikonfirmohet zyrtarisht se pasuritë janë të llojit arë dhe pemëtoare. Pas marrjes së përgjigjeve nga ana e Bashkisë dhe Këshillit të Qarkut Lezhë, punonjësit e ZVRPP-së Lezhë, kanë proceduar me regjistrimin e këtyre pasurive, ku sipas dispozitave ligjore të ligjit 7051, datë

19.07.1991 "Për tokën", si dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, nga ana e tyre nuk duhej të procedohej me regjistrimin e këtyre pasurive. Pas regjistrimit të këtyre pasurive në Zyren Vendore të Pasurive të Paluajtshme Lezhë, në një kohë shumë të shkurtër, përfituesit e paligjshëm, e kanë tjetërsuar pronësinë, duke e shitur me çmime simbolike në emër të personave të tjerë apo edhe të lidhjeve të tyre familjare, sipas kontratave të bllokua. Personat përgjegjës për përpilimin e këtyre praktikave të regjistrimit të pasurive në emër të shtetasve të sipërcituar janë specialisti i zyrës së kadastrës, shefja e kadastrës, kryetari i Bashkisë Lezhë Fran Frrokaj, pasi këta shtetas në bashkëpunim me njëri-tjetrin, në kundërshtim të plotë me kërkesat e ligjit 7051, si dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij kanë administruar, konfirmuar dhe dërguar për regjistrim dokumentacion të falsifikuar në përmbajtje dhe formë, për pasuri që janë, në fakt, tokë pyll, ranishte, shkurre, shkëmb, dhe jo tokë bujqësore. Nga ana e Këshillit të Qarkut Lezhë janë konfirmuar me shkresë se pasuritë e sipërcituara janë të llojit pemëtoare, ndërkohë që, në fakt, sipas akt ekspertimi topografik është tokë pyll, ranishte, shkurre dhe shkëmb. Për këto veprime mbajnë përgjegjësi, specialisti i Arshivës dhe kryetari i Këshillit të Qarkut Lezhë, Gjok Ndoka. Nga ana e ZVRPP-së Lezhë,



Bregdeti i Shëngjinit

Futbollisti i Vllaznisë: Tokën e kam trashëguar nga gjyshi, jam në shtëpi e jo në kërkim

Futbollisti i Vllaznisë, Renato Malota është i akuzuar si pjesë e dosjes për tjetërsim të pronave në zonën e quajtur "Rana e hedhun" në Shëngjin. Në skandalin e pronave në Lezhë, emri i Marlotës përmendet si një nga shumë përfituesit. I kontaktuar nga "News 24", futbollisti Malota u shpreh: "Unë nuk kam asnjë lidhje me atë që flitet, është një gabim. E gjitha ka ndodhur se unë kam biznesin tim aty pranë, është një ngatërresë. Unë nuk njoh asnjërin dhe nuk kam asnjë lidhje me kryetarin e bashkisë që është arrestuar". Ndërkaq, ai sqaroi se "në pjesën ranore kam ndërtuar një lokal me lejen e bashkisë, ndërsa pas pjesës ranore kam tokën të trashëguar nga të parët. Unë jam me origjinë nga vendi ku bëhet fjalë, aty kam tokën time, ndërsa po theksoj edhe njëherë që lokalin e kam ndërtuar në pjesën ranore me lejen e bashkisë. Lajmin e mësova nga televizionet kur isha në stërvitje në Shkodër. Aktualisht ndodhem në banesë në Tiranë, lajmi që jam në kërkim është i pavërtetë".



regjistruesi, juristi, hartografi, kanë pranuar administruar dhe regjistruar dokumentacionin e pasurive në emër të shtetasve të sipërcituar në kundërshtim me ligjin 7051. Toka e përfitur është shitur me

dokumentacion të falsifikuar duke përfitur paretësisht shumë moneta të konsiderueshme. Vazhdon puna për identifikimin zyrtarëve e personave të tjerë të implikuar në këtë aktivitet kriminal.



**SHKURRI XHELILI/
DIBËR**

Historia e ish-kryebashkiakut të Dibërës bëri bujë në maj të 2016-ës, kur edhe u arrestua. Kryebashkiaku socialist Shukri Xhelili u denoncua nga një 20-vjeçare, pasi i kishte kërkuar asaj favore seksuale në këmbim të një vendi pune. Si provë kundër ish-kryebashkiakut ishte edhe një videoregjistim, që e implikonte në aferën seksuale në këmbim të punësimit.



**BEQIR NUREDINI/
RROGOZHINË**

Kryetari i Bashkisë së Rrogozhinës, Beqir Nuredini u shoqërua muajin që shkoj në polici. Prokuroria ka nisur një hetim që lidhet me abuzimet në ndërtimin e pikave të shërbimit në Spille, e ku rezultojnë të implikuar edhe të tjerë persona. Nuredini i është bllokuar edhe pasaporta për të mos dalë nga vendi, për shkak të dosjes me abuzimet me pronat në bregdet.



**ELVIS RROSHI/
KAVAJË**

Ligji për dekriminalizimin ka vënë në pranga ish-kryebashkiakun e Kavajës, Elvis Rroshi. Ai është arrestuar më 13 qershor të vitit 2016, pasi prokuroria e akuzoi për falsifikim të vulave, stampave dhe formularëve në plotësimin e formularit të "Dekriminalizimit". Sipas prokurorisë, Rroshi nuk ka deklaruar dënimin për përdhunim nga drejtësia italiane në 1995.

Operacioni i koduar "Ranishtja 4", policia shpall në kërkim edhe 11 vetë

Abuzimi me pronat në bregdet, arrestohet kryebashkiaku i Lezhës, Fran Frrokaj

Përfundojnë në pranga edhe 11 zyrtarë e persona të tjerë



LEZHË

Abuzimi me pronat në bregdetin e Lezhës ka çuar në pranga kryetarin e bashkisë së këtij qyteti, Fran Frrokaj, 52-vjeçar, (përfaqësues i Partisë Demokratike) i zgjedhur në këtë post në qershor të vitit 2015 akuzohet për shpërdorim detyre dhe konkretisht për tjetërsim të pronave në zonën e quajtur "Rana e Hedhun" në Shëngjin. Në pranga kanë rënë edhe nënkryetari i Bashkisë së Lezhës, Enver Hafizi, kryetar i këshillit të qarkut të Lezhës, Gjok Ndoka (vëllai i ish-deputetit socialist, Arben Ndoka) dhe zyrtarë të tjerë. Në lidhje me abuzimet e bëra me pronat, prokuroria ka lëshuar 23 urdhër-arreste. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Lezhës mbrëmë bënë me dije se në kuadër të operacionit "Ranishtja 4" janë arrestuar dhe ndaluar 12 zyrtarë publikë, ndërsa janë shpallur në kërkim 11 të tjerë. Sipas policisë, këta persona në bashkëpunim me njëri-tjetrin duke abuzuar me detyrën kanë falsifikuar, tjetërsuar dhe përvetësuar 234,548 m² tokë shtetërore ranishte në zonën bregdetare Shëngjin, tek vendi i quajtur "Rana e Hedhun". Mëshohet se kjo sipërfaqe është shndërruar me dokumente të falsifikuara nga tokë shtetërore në bregdet, në tokë arë dhe pentore. Më pas është regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Paturisë së Paluajtshme Lezhë (ZRPP), duke përfutur padrejtësisht në interes të tyre dhe personave të tjerë. Këto hetime proaktive janë kryer në funksion të procedimit penal, regjistruar në vitin 2017, për veprat penale të "Shpërdorimit të detyrës" dhe "Falsifikimi i dokumenteve". Mbi bazën e provave të grumbulluara dhe sekuestruara nga Sektori për Hetimin e Korrupsionit dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë, Gjykata e Shkallës së Parë Lezhë, me vendim dhe datës 15 mars 2018 ka vendosur masën e sigurisë personale "Arrest



Afera me pronat, mes të arrestuarve edhe shaxhai i ish-deputetit Ndoka

LEZHË - Mes personave të arrestuar gjatë operacionit të koduar "Ranishtja 4" për shpërdorim detyre dhe abuzim me pronat në bregdet është edhe Gjok Ndoka, kryetar i Këshillit të Qarkut të Lezhës dhe përfaqësues i Partisë Socialiste. Ai është shaxhai i ish-deputetit socialist, Arben Ndoka. Prokuroria e Krimeve të Rënda ka lëshuar 23 urdhër-arreste për zyrtarë të bashkisë Lezhë dhe Hipotekave. Krahas kryebashkiakut Fran Frrokaj, zëvendësit të tij, Enver Hafizi dhe zyrtarëve të tjerë bashkiakë, është në arrest shtëpie dhe drejtoresha e Drejtorisë së Bujqësisë në bashkinë e Lezhës Gjelina Bacaj dhe persona të tjerë. Ndërkaj, policia po punon për arrestimin e 11 personave të shpallur në kërkim.



Kryetari i bashkisë së Lezhës, Fran Frrokaj



Nënkryetari i Bashkisë së Lezhës, Enver Hafizi

ABUZIMI ME PRONAT NË LEZHË

PERSONAT E ARRESTUAR

1. Fran Frrokaj, 52 vjeç, lindur dhe banues në Lezhë, me detyrë kryetar i Bashkisë Lezhë.
2. Enver Hafizi, 62 vjeç, lindur dhe banues në Lezhë, me detyrë nënkryetar i Bashkisë Lezhë.
3. Gjok Ndoka, 52 vjeç, lindur dhe banues në Lezhë, me detyrë kryetar Këshillit të Qarkut Lezhë.
4. Adenis Haxhia, 29 vjeç, lindur dhe banues në Lezhë, me detyrë jurist pranë Bashkisë Lezhë.
5. Dilaver Neli, 56 vjeç, lindur dhe banues në Lezhë, me detyrë specialist në Drejtorinë e Mbrojtjes së Tokës të Këshillit Qarkut, Lezhë.
6. Enkelejd Zefi, 28 vjeç, lindur dhe banues në Lezhë, me detyrë specialist hartograf pranë ZVRPP Lezhë.
7. Pjetër Gjoni, 68 vjeç, lindur dhe banues në Lezhë, përfuttes tokë në mënyrë të paligjshme.

ZYRTARËT ME "ARREST SHTËPIE"

8. Gjelina Baca, 58 vjeçe, me banim në Lezhë, me detyrë drejtoreshë e Drejtorisë së Bujqësisë në Bashkinë Lezhë.
9. Juxhina Mema, 25 vjeçe, lindur dhe banues në Gramsh, me detyrë ish-specialiste në Drejtorinë e Bujqësisë në Bashkinë Lezhë.
10. Marte Gjergji, 50 vjeçe, me banim në Lezhë, me detyrë përfuttes tokë në mënyrë të paligjshme.
11. Frok Frroku, 75 vjeç, me banim në Bashkinë Mamurras, ka përfuttes tokë në mënyrë të paligjshme.
12. Luigj Paloka, 76 vjeç, me banim në Shkodër, ka falsifikuar aktet.

PERSONAT NË KËRKIM

- EDUART LEKA, (ish-arkivist komuna Shëngjin)
- ARTAN DJALA, (ish-drejtor i Hipotekës)
- BLEDAR CARA, (jurist në Hipotekë)
- RENATO MALOTAJ, (përfuttes i tokës)
- NDUË FRROKU, (përfuttes i tokës)
- ZEF GJINI, (përfuttes i tokës)
- VASIL GJONI, (përfuttes i tokës)
- LEK FRROKU, (përfuttes i tokës)
- MARTIN FRROKU, (përfuttes i tokës)
- LUIGJ PALOKA, (topograf)
- ARMANDO JAKAJ

Këshillit të Qarkut Lezhë; Adenis Haxhia, 29 vjeç, lindur dhe banues në Lezhë, me detyrë jurist pranë Bashkisë Lezhë; Dilaver Neli, 56 vjeç, lindur dhe banues në Lezhë, me detyrë specialist në Drejtorinë e Mbrojtjes së Tokës të Këshillit qarkut Lezhë; Enkelejd Zefi, 28 vjeç, lindur dhe banues në Lezhë, me detyrë specialist hartograf pranë ZVRPP Lezhë dhe Pjetër Gjoni, 68 vjeç, lindur dhe banues në Lezhë, përfuttes tokë në mënyrë të paligjshme. Ndërsa janë lënë në arrest shtëpie zyrtarët: Gjelina Baca, 58 vjeçe, me banim në Lezhë, me detyrë drejtoreshë e Drejtorisë së Bujqësisë në Bash-

kinë Lezhë; Juxhina Mema, 25 vjeçe, lindur dhe banues në Gramsh, me detyrë ish-specialiste në Drejtorinë e Bujqësisë në Bashkinë Lezhë; Marte Gjergji, 50 vjeçe, me banim në Lezhë, me detyrë topografe pranë Bashkisë Lezhë; Frok Frroku, 75 vjeç, me banim në Bashkinë Mamurras, ka përfuttes tokë në mënyrë të paligjshme dhe Luigj Paloka, 76 vjeç, me banim në Shkodër, ka falsifikuar aktet. Gjithashtu, janë shpallur në kërkim dhe punohet për kapjen e 11 shtetasve, me detyra në ZVRPP, në ish-Komunën Shëngjin apo përfuttes tokash në mënyrë të paligjshme.

në burg" për zyrtarët e administratës shtetërore dhe për shtetas të tjerë, të cilët janë ekzekutuar për shtetasit: Fran Frrokaj me detyrë kryetar i Bashkisë Lezhë;

Enver Hafizi, 62 vjeç, lindur dhe banues në Lezhë, me detyrë nënkryetar i Bashkisë Lezhë; Gjok Ndoka, 52 vjeç, lindur dhe banues në Lezhë, me detyrë kryetar

PROJEKTLIGJI TERHEQJA

Nëntë deputetë kërkuar shfuqizimin e "20 shkurtit" dhe vendosjen e "26 shkurtit"

Viktimat e komunizmit, PD tërheq nismën për ndryshimin e datës

Salianji: Pamë ndjeshmërinë e ish-të përndjekurve

Valentina Madani

Pak javë pasi depozitu an në Kuvend një nismë ligjore për shfuqizimin e "20 shkurtit", që njihet si dita e rrëzimit të bustit të diktatorit Hoxha dhe e përkujtimit të viktimave e krimeve të komunizmit në Shqipëri, Partia Demokratike është tërhequr. Në projektligjin që mban firmën e 9 deputetëve, demokratët propozojnë që kjo datë të zëvendësohet me 26 shkurtin, ndonëse në 2010-ën mazhoranca e drejtuar nga Sali Berisha miratoi asokohe në Kuvend me ligj "20 shkurtin" si ditën e përkujtimit të viktimave dhe krimeve të komunizmit. Firmëtarët e këtij projektligji argumentojnë se kanë përzgjedhur pikërisht këtë datë, pasi në vitin 1951 nga regjimi i kohës u pushkatuan 22 intelektualë me pretekstin se kishin hedhur në oborrin e ambasadës sovjetike një copë dinamiti. Ervin Salianji, njëri prej firmëtarëve të kësaj nisme, e konfirmon tërheqjen e PD-së. "Duke parë ndjeshmërinë e ish-të përndjekurve, PD e ka tërhequr nismën për ta zgjeruar në kuadër të një grupi pune që ka ngritur PD-ja", shprehet z. Salianji. Partia Demokratike, në bashkëpunim me fondacionin "Konrad Adenauer" ka ngritur një grup pune për hartimin e ligjit "Për ndalimin e përkujtimit të viktimave të komunizmit. Grupi i punës drejtohet nga deputeti Enkelejd Alibeaj dhe sapo të përfundojë draftin, do të diskutohet me ish-të përndjekurit politikë. Për këtë arsye, PD tërhoqi sot një nismë të ngjashme të disa deputetëve të saj. Që nga viti 2010, si ditë e përkujtimit të viktimave të komunizmit ishte shpallur data 20 shkurt, dita e rrëzimit të bustit të diktatorit Enver Hoxha. Por pak ditë më parë, disa deputetë të PD-së kishin depozituar në Kuvendin e Shqipërisë një nismë ligjore për të ndryshuar këtë datë, e për të vendosur 26 shkurtin, ditën e kur regjimi i Enver Hoxhës vrau 22 intelektualë. Por, burime nga PD-ja kanë bërë të ditur se PD ka tërhequr nga Kuvendi nismën e 9 deputetëve të saj, mes të cilëve



Selia e PD-së

BESNIK MUSTAJ

"Vendosja e datës 20 shkurt është triumfi i vërtetë mbi komunizmin. Është një improvizim që tregon mungesën e kohezionit që ka PD-ja në aksionin e saj. 26 shkurti sjell në memorien e kombit tonë një nga aktet më barbare", u shpreh Mustafaj për "News 24".

Porositë për Kuvendin dhe elektoratin

Basha, kryetarëve të degëve: Flisni dhe propozoni pa frikë!

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, mboldhi pasditën e djeshme krerët e degëve në rrethe. Ai i informoi ata mbi vendimin e kryesisë për mbledhjen e Kuvendit Kombëtar të PD. Në fokus të takimit ishte mbledhja e Kuvendit Kombëtar në pranverë, nga ku PD do të nisë fazën për riorganizimin e saj. Kjo, pas analizës për humbjen e zgjedhjeve të vitit 2017. Basha u dha lirinë e shprehjes drejtuesve të degëve për idetë e tyre. "Të gjithë të kenë hapësirë të bëjnë propozime. Në mbledhjen e Kuvendit, në datat 28 dhe 29 prill, të jenë të pranishëm të gjithë që janë pjesë e Kuvendit", tha Basha. Kryedemokrati



Kreu i PD-së Lulzim Basha

dha atyre disa udhëzime në lidhje me elektoratin si dhe me anëtarësinë në secilën degë. "Duhet parë procesi i riorganizimit, të mos zhvendoset vëmendja nga takimet me elektoratin. Duhet të rifreskoni anëtarësinë në secilën degë", mësohet të

ketë thënë Basha. Nga ana tjetër, Basha ka kërkuar nga krerët e degëve që riorganizimi i partisë të mos e zhvendosë vëmendjen nga takimet me elektoratin. "Rifreskoni anëtarësinë në secilën degë", - ka porositur Basha.

edhe Edi Paloka, Grida Duma, Ervin Salianji, Flamur Noka, Genc Pollo, Edmond Spaho të cilët kërkojnë ndryshimin e datës për përkujtimit të viktimave të regjimit komunist. Konkretisht, ata kërkojnë shfuqizimin e nenit e të ligjit nr. 10 241, datë 25.2.2010 për simbolet e përkujtimit të viktimave dhe të krimeve të komunizmit në Shqipëri. Përkujtimi i kësaj date, sipas ligjit, bëhet në përpunje me legjislativon në fuqi". Befasia qëndron në faktin se 9 deputetë demokratë i

kërkojnë Parlamentit që të shfuqizojnë në tërësi nenin 3 të ligjit nr. 10 241, datë 25.2.2010, duke përfshirë edhe paragrafin që parashikon përkujtimit të datës së rrëzimit të bustit të Enver Hoxhës, që çoi me pas në rënien graduale të regjimit komunist në Shqipëri. Ndërkaq, në vend të datës 20 shkurt, deputetët e PD-së kërkojnë që të caktohet data 26 shkurt si dita e kujtesës së viktimave të regjimit komunist.



Kryeministri Edi Rama, dje në konferencën e INSTAT me temë "Sfidat e emigracionit"

ASTRIT PATOZI

"Po mirë mor Lulzim, nuk të mjafton që ndahemi me PS dhe LSI për datën e Çlirimit të Shqipërisë!? Duhet që edhe brenda Partisë Demokratike të kemi patjetër dy data për të përkujtuar viktimat e komunizmit? Po socialistët njësoj e kanë çfarëdo propozimi që t'u çosh, se ata nuk kanë ndonjë ndjeshmëri për krimet e diktaturës dhe për simbolet tona", shkruan Patози.



Majlinda Bregu

Bregu: Nis me heqjen e simboleve, pastaj ndalohet hyrja në PD

PD ka depozituar një projektligj të firmosur nga një grup deputetesh, i cili parashikon shfuqizimin e datës 20 shkurt, si dita e përkujtimit të viktimave dhe përkujtimit të komunizmit në Shqipëri, duke kërkuar që kjo datë të jetë data 26 shkurt 1951. Ish-deputetja demokrate, Majlinda Bregu shkruan në 'FB' se, "nuk kemi të bëjmë veç me ndryshimin e një ligji të Sali Berishës me një ligj të Lulzim Bashës, por 'tallja me dekomunistizimin'. Kështu nis: hiqen simbolet e partisë në fushatë, vritet memoria historike e partisë, shkatërrohet grupi parlamentar, flaket ideologjia, të braktisin shtresat mbështetëse dhe pastaj ngulet tabela në hyrje të selisë së Partisë: 'Tokë e zanun! Ndalohet kalimi!', - shkruan ajo. Sipas Bregut është e turpshme është tallja me dekomunistizimin. "Pse duhet shfuqizuar dita simbol e 20 shkurtit? Datat përkujtimitore nuk shfuqizojnë njëra-tjetrën. Pse të mos shtohet në ligj edhe data 26 shkurt? A është ky problemi më i madh që ka PD-ja sot? Pse Lulzim Basha nuk propozon një projektligj për të ndaluar depërtimin në institucionet e shtetit dhe për të nxjerrë jashtë sistemit të drejtësisë, bashkë me vetëgungun, ata gjyqtarë dhe prokurorë që sot kanë depërtuar edhe në KLGJ e KLP, të cilët mbajnë vullën e dënimeve politike para rënies së komunizmit? Në shtator të 2017-ës, Lulzim Basha mori përsipër hartimin e ligjit për ndalimin e përdorimit të simboleve të komunizmit dhe dënimit e atyre që i përdorin, sipas modelit Gjerman? Pse nuk u mor vesh kurrë kush nga grupi antikomunist i Bashës i dhuroi tri vota Gramoz Ruçit, që të zgjidhje kryetar parlamentit?", shprehet zj.Bregu.



AMBASADORJA

"Ne nuk mirëpresim abuzimin me këto tre drejta të lëvizjeve. Numri i emigrantëve dhe azilkërkuessve është akoma tepër i lartë. Shqipëria është një vend kandidat i BE, jo vend me persekutim politik, që ishte një nga arsytet për të dhënë azil dhe do të kthehen në Shqipëri edhe me forcë, nëse duhet, dhe do të ndalohen të hyjnë në Gjermani deri në 5 vjet", tha Schutz.

Konferenca për emigracionin, kryeministri: Mundësi strehimi për çiftet e reja

Ambasadorja gjermane: S'ka azil Edi Rama: Shkoni si të kualifikuar

Schutz: Shqipëria nuk është një vend me persekutim politik

Darina Tanushi

Ambasadorja e Gjermanisë në Shqipëri, Susanne Schütz, deklaroi dje në një konferencë të INSTAT me temë "Sfidat e emigracionit", se azilantët do të kthehen, nëse është e nevojshme, edhe me forcë në Shqipëri dhe do t'u ndalohet hyrja për pesë vjet në Gjermani. Në konferencën ku i pranishëm ishte edhe kryeministri Edi Rama, ambasadorja gjermane tha se Shqipëria është një vend kandidat i BE dhe jo një vend me persekutim politik. "Shqipëria është një vend kandidat i BE dhe jo vend me persekutim politik, që ishte një nga arsytet për të dhënë azil dhe do të kthehen në Shqipëri edhe me forcë, nëse duhet, dhe do të ndalohen të hyjnë në Gjermani deri në 5 vjet", u shpreh ambasadorja gjermane. Sipas saj, rruga e vetme për të shkuar në Gjermani në mënyrë të rregullt është duke u pajisur me një vizë pune. "Pavarësisht këtyre politikave, tregu është i hapur për ata punëtorë të kualifikuar. Nëse plotësojnë kushtet, ata kanë mundësi të aplikojnë për viza punë dhe 3 mijë shqiptarë kanë përfutur në 2017 nga kjo. Bashkëpunimi me zyrën e punësimit ofron mundësi për të kualifikuarit në Shqipëri", tha Schutz. "Ndërsa shumë shqiptarë largohen nga vendi, jo vetëm në Gjermani, por edhe në vende të tjera perëndimore, dëgjoj shpesh nga të rinjtë që ata do të preferonin të qëndronin në Shqipëri, nëse do të kishin një shans më të mirë për të gjetur punë dhe për të siguruar një jetë më të mirë dhe kujdes të mirë shëndetësor. Kjo është një sfidë e madhe për qeverinë shqiptare dhe unë e vlerësoj që qeveria shqiptare është e vendosur për të siguruar një jetë më të mirë për shqiptarët këtu", theksoi më tej ambasadorja. Ndërsa për kryeministrin, numri i azilantëve shqiptarë ka rënë ndjeshëm kohët e fundit, ndërsa tha se me këtë fenomen është spekuluar. "U bë shumë zhurmë dhe u bënë shumë spekulime me azilkërkuessit shqiptarë. Sot jemi në kushtet kur kemi një rënie drastike të numrit të azilkërkuessve", tha Rama. Sipas kryeminis-



Ambasadorja e Gjermanisë në Shqipëri, Susanne Schütz

SHEMBULLI

"Në Italinë e Jugut, fenomeni i largimeve është tanimë kronik, i cili as nuk është frenuar e as nuk është shmangur dot, nëse bëhet fjalë për një vend anëtar të G7, një ndër 7 vendet më të industrializuara të botës dhe një nga destinacionet e vetë shqiptarëve për të emigruar", mori si shembull dje kryeministri.

trit, emigrimi është një fenomen normal dhe i përhapur edhe në vendet e BE, ndërsa vlerësoi kontributin e tyre për ekonominë shqiptare. "E nëse 50.000 njerëz janë larguar nga

Kroacia, anëtare e Bashkimit Europian, në vitin 2017 nga Shqipëria janë larguar 39.905", krahasoi ai. Por, duke theksuar se ka një rikthim të emigrantëve, Rama tha se, "kësaj tendence ne duhet të

jemi në gjendje t'i japim përgjigje adekuatë, hap pas hapi, në funksion të integritetit të atyre që kthehen në tregun shqiptar të punës dhe në radhë të parë, në funksion të mundësimit të investimeve të kursimeve të tyre në ekonominë kombëtare". Kryeministri tha se shqiptarët mund të shkojnë në Gjermani jo duke u paraqitur si azilkërkuess, por si njerëz me kualifikime të ndryshme. Duke folur për politikën e qeverisë, Rama tha se qeveria është duke punuar "për një Program Kombëtar Strehimi në funksion të çifteve të reja". "Besojmë se ka një mundësi të madhe që duke adresuar siç duhet nevojën e çifteve të reja për strehim dhe duke u krijuar të rinjve një mundësi reale strehimi, ne ta bëjmë qëndrimin e tyre në vend shumë më të mundshëm dhe tundi-min për t'u larguar, qoftë dhe për faktin se s'mund të kenë një shtëpi të tyre, shumë më të ulët. Nuk është një shpikje. Është një masë kombëtare, që vende të tjera e kanë bërë përpara nesh, me shumë sukses", tha Rama.

Mesi: Reforma në shërbime po shëron sëmundjen e mosbesimit ndaj shtetit

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) prezantuan dje gjetjet e sondazhit "Besimi në Qeverisje 2017", zhvilluar në nëntor të 2017-ës. Gjetjet tregojnë se institucionet publike që gëzojnë besimin më të madh janë Forcat e Armatosura (63%), Institucionet e Arsimit Publik (63%), Institucionet e Shëndetit Publik (53%) dhe Policia e Shtetit (53%). Prokuroria (22%), Gjykatat (21%) dhe Partitë Politike (21%) rezultojnë të jenë institucionet më pak të besuara. Në lidhje me institucionet e tjera kombëtare, Institucionet Fetare (76%), Organizatat e Shërbësive Civile (57%) dhe Media (54%) janë më të besuarat. Krahasuar me vitin 2016, 7 institucione kanë shënuar rritje në besim, përkatesisht: qeveria (rritje me 3 pikë përqindje), Institucionet e Shëndetit Publik (rritje me 3 pikë përqindje), Institucionet e Arsimit Publik (rritje me 4 pikë përqindje), Parlamenti (rritje me 7 pikë përqindje), Forcat e Armatosura (rritje me 8 pikë përqindje), Shërbësit civilë (rritje me 11 pikë përqindje) dhe Institucionet Fetare (rritje me 18 pikë përqindje). Të dhënat e "Sondazhit të Opinioni" për vitin 2017 tregojnë se 8 nga 10 të anketuar e konsiderojnë korrupsionin e nivelit të ulët (87%) dhe të lartë (88%) si të përhapur ose shumë të përhapur në Shqipëri. Në fjalën e saj, zëvendëskryeministria e Republikës së Shqipërisë, Senida Mesi theksoi se përpjekjet e qeverisë shqiptare lidhur me reformat transformuese për të rritur besimin e qytetarëve në qeverisje janë reforma në drejtësi dhe vetingu, operacioni "Forca e Ligjit" dhe vetingu në radhë të policisë, si dhe reforma e shërbimeve publike dhe administrative. Ajo u shpreh: "Duke rindërtuar një sistem të ri vlerash, po shërojmë sëmundjen e cinizmit dhe mosbesimit ndaj shtetit. Shqiptarët kanë nevojë dhe meritojnë shërbime cilësore, të modernizuara dhe dixhitale, që ua lehtësojnë jetën dhe punën dhe kjo rrit besimin tek shërbimet dhe administrata publike".



Ambasadorja e BE-së bën thirrje nga Kukësi

Vlahutin: Azili nuk është zgjidhje, duhet të krijojmë mundësitë këtu

Ambasadorja e Bashkimit Evropian në Tiranë, Romana Vlahutin i dërgoi një mesazh qeverisë nga Kukësi, duke i sugjeruar që të ndalojë largimin e të rinjve për qëllime azili në vendet e BE-së përmes punësimit. Duke përsëritur qëndrimin se shqiptarët nuk kanë asnjë mundësi përfitimi si azilkërkuess, zonja Vlahutin tha se zgjidhja është krijimi i mundësive këtu. "Diskutuam çfarë mund të bëjmë më shumë për punësimin, pasi Kukësi është një prej bashkive që po humbasin më shumë të rinj. Shumë prej tyre po kërkojnë atë që është e pamundur, azil në vendet e BE, por kjo nuk është rruga. Ajo çfarë duhet bërë është të krijojmë mundësi këtu", u shpreh Vlahutin,



pas takimit që pati në bashkinë e këtij qyteti. E pranishme në Kukësi për inspektimin e disa investimeve me fondet e BE, zonja Vlahutin theksoi se të gjitha ndërhyrjet që do të bëhen në të ardhmen, duhet të bëhen të mirëplanifikuara. "Diskutuam për aeroportin e Kukësit. Jemi në pritje të studimit të fizibilitetit dhe çfarë mund të bëjmë më tej", tha ambasadorja Vlahutin. E pyetur në

lidhje me lejet për ndërtime dhe disa hidrocentrale në Shishtavec, ambasadorja e BE tha se do të marrë më shumë informacion, por theksoi se ndërtimi i infrastrukturës dhe ruajtja e mjedisit është një sfidë e madhe. Kukësi është një prej bashkive që ka përfutur më shumë projekte nga BE, mes të cilave rruga e Shishtavecit dhe dogana e Morinit.

Ministri në takimin për Ballkanin Perëndimor: Angazhim i përbashkët

Bushati në Sarajevë: Moment i favorshëm për zgjerimin e BE

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, ndodhet në Sarajevë, ku po merr pjesë në takimin e ministrave të Punëve të Jashtme të Ballkanit Perëndimor. Në këtë takim morën pjesë edhe zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Punëve të Jashtme të Bullgarisë, vend i cili mban Presidencën e Këshillit të BE si dhe Drejtori i Përgjithshëm për Zgjerimin në Komisionin Evropian, Christian Danielsson. Takimi u mbajt në vëmje të Strategjisë së Zgjerimit të Komisionit Evropian dhe në kuadër të përgatitjeve për Samitin BE-Ballkani Perëndimor, i cili do të zhvillohet në Sofje në maj të këtij viti

TAKIMI

Ministrat theksuan nevojën për t'i dhënë një shtysë të re procesit të integritimit dhe për të konkretizuar përgjegjësitë e ndërmarra në kuadër të Procesit të Berlinit. Ministri Bushati nënvizoi rëndësinë thelbësore të një angazhimi të përbashkët me vullnet politik dhe me instrumente konkrete.

si dhe për takimin e radhës së Procesit të Berlinit, i cili do të mbahet këtë verë në Londër. Ministrat theksuan nevojën për t'i dhënë një shtysë të re

procesit të integritimit dhe për të konkretizuar përgjegjësitë e ndërmarra në kuadër të Procesit të Berlinit. Ministri Bushati nënvizoi rëndësinë thel-

bësore të një angazhimi të përbashkët me vullnet politik dhe me instrumente konkrete, me qëllim shfrytëzimin e momentit të favorshëm sa i përket frymës së zgjerimit. Në takim u vlerësua se kjo mund të arrihet, ndër të tjera, përmes marrëdhënieve të konsoliduara të fqinjësisë së mirë dhe angazhimit me përkushtim ndaj avancimit të procesit të integritimit. Gjatë Konferencës Ministeriale të



Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, dje në Sarajevë

Fondit të Ballkanit Perëndimor, u theksua se ky është një mekanizëm i rëndësishëm dhe me shumë impakt në forcimin e bashkëpunimit ra-

jonal dhe ndërtimin e urave të reja të besimit mes palëve, si mënyrat më të mira për garantimin e sigurisë dhe stabilitetit në rajon.

Kreu i Shtetit dhe ish-presidentët janë mbledhur së bashku në forumin e Baku-t

Meta takon Berishën, Meidanin e Nishanin, biseda mes tyre

Presidenti me kryeministrin turk: Partner kryesor ekonomik



Presidenti i Republikës, Ilir Meta me kryeministrin e Republikës së Turqisë, Binali Yıldırım

Darina Tanushi
Presidenti i Republikës, Ilir Meta është takuar dje, në Baku të Azerbajxhanit me tre prej paraardhësve të tij, ish-presidentët Sali Berisha, Rexhep Meidani e Bujar Nishani. Të katërt janë të pranishëm në forumin e 6-të Baku-së, me temë: "Mbyllja e boshllëqeve për krijimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse" dhe kanë gjetur momentin të bisedojnë mes tyre, në një pushim të këtij aktiviteti. Nuk dihet nëse të katër figurat shqiptare kanë marrë më shumë kohë më pas për t'u ulur e biseduar më gjatë mes tyre apo kjo bisedë ka qenë e shkurtër. Ata e takuan kreun e shtetit, pak javë më parë, por veç e veç, për të dhënë mendimet e tyre në lidhje me kërkesën që Presidenti Meta ka marrë nga Ministria e për Evropën dhe Punët e Jashtme, sa i përket nisjes së negociatave zyrtare me palën greke për një marrëveshje të re për paktin detar. Në këtë aktivitet në Baku të Azerbajxhanit nuk kanë qenë të pranishëm dy ish-presidentët e tjerë, Alfred Moisiu e Bamir Topi. Nga ana e tij, ish-presidenti Sali Berisha ka mbajtur edhe një fjalë në këtë forum me temën "Si ndikojnë fuqitë e reja në çështjet globale". "Bota e sotme është një botë plot hendeqe, duke penguar krijimin e një shoqërie me të vërtetë gjithëpërfshirëse, të çliruar nga vështirësitë ekonomike, konfliktet e



Presidenti i Republikës, Ilir Meta me tre prej paraardhësve të tij, ish-presidentët Sali Berisha, Rexhep Meidani e Bujar Nishani

BISEDA

Të katërt janë të pranishëm në forumin e 6-të Baku-së, me temë: "Mbyllja e boshllëqeve për krijimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse" dhe kanë gjetur momentin të bisedojnë mes tyre, në një pushim të këtij aktiviteti.

dhunshme, degradimi intelektual dhe moral. Në një botë që nuk është më njëpolare, por ku një numër fuqish botërore dhe rajonale po rriten fuqishëm, balancat po ndryshojnë duke ndikuar edhe në jetën e shoqërive të vendeve të tjera", bëri me dije, Berisha, përmes rrjetit social.

TAKIMI

Nërkohë, Presidenti i Republikës Ilir Meta zhvilloi dje, një takim me kryeministrin e Republikës së Turqisë,

zotin Binali Yıldırım, i cili, gjithashtu, merr pjesë në Forumin Global të Baku-së. Presidenti Meta vlerësoi marrëdhëniet tradicionalisht miqësore e vëllazërore, si dhe të partneritetit strategjik ndërmjet dy vendeve dhe shprehu mirënjohjen për mbështetjen që Turqia i ka dhënë shqiptarëve ndër vite. Në mënyrë të veçantë, Presidenti Meta vlerësoi rolin dhe kontributin e dhënë nga agjencia shtetërore turke për bashkëpunim dhe koor-

BASHKËPUNIMI
Presidenti Meta vlerësoi dje, gjatë takimit me kryeministrin turk, se Turqia është një nga partnerët kryesorë ekonomik e tregtar për Shqipërinë dhe nënvizoi se, mundësitë e rritjes së këtij bashkëpunimi, si në aspektin tregtar, ashtu edhe atë të investimeve të drejtpërdrejta turke, që po rriten në mënyrë që qëndrueshme, janë të mëdha.

dinim, TIKA, e cila është e pranishme dhe e ka shtrirë aktivitetin e saj mbështetës në të gjithë vendin. Presidenti Meta vlerësoi, gjithashtu, se Turqia është një nga partnerët kryesorë ekonomik e tregtar për Shqipërinë dhe nënvizoi se, mundësitë e rritjes së këtij bashkëpunimi, si në aspektin tregtar, ashtu edhe atë të investimeve të drejtpërdrejta turke, që po rriten në mënyrë që qëndrueshme, janë të mëdha. Duke u ndalur në çështjet e sigurisë, Presidenti Meta theksoi se, si dy vende aleate në NATO dhe partnere prej vitesh, Shqipëria dhe Turqia do të vijojnë bashkëpunimin e tyre të ngushtë në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar, organizatave terroriste dhe kërcënimeve të tjera të përbashkëta.

Vasili: Shqipëria pa një drejtim shtetëror, nuk ka takim me Ramën

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI, Petrit Vasili akuzoi kryeministrin e vendit për situatën ekonomike, në të cilën ndodhet aktualisht vendi. Vasili tha që heqja e ndihmës ekonomike është jo një ndihmë jetike, por ndihmë biologjike për bukën e gojës. "Ky shtet i Edi Ramës, me gafa të rrënuara të skemës ekonomike është një sistem i shthurur. Paketa që qeveria ofroi apo ndihma ekonomike nuk ofron jo minimumin jetik, por as minimumin biologjik. Shqipëria e këtij kryeministri nuk lufton dot as varfërinë. Të heqë koncesionet, të ndihmojë për mbijetesën nga uria. Nga dje është fare qartë se shqiptarët janë pa një drejtim shtetëror. Ka vetëm një objektiv, të shpërdorojë për palma të thara, dhe sheshe po frytdhënëse", u shpreh Vasili. I pyetur nga gazetarët lidhur me takimin që është aluduar në media për një takim mes Kryemadhit edhe Ramës, Vasili u shpreh se mes tyre nuk ka pasur dhe nuk do të ketë asnjëherë ndonjë takim. Nuk ka pasur asnjë takim të zonjës Kryemadhi me kryeministrin e vendit, Zonja Kryemadhi ka pasur dhe ka vendosur një standard, transparencën absolute në takimet politike. Për sa i takon pozicionin LSI janë të vendosur shumë qartë në opozitë. Salla e parlamentit tregoi këtë gjë, votimi tregoi të njëjtën gjë. Dje jo vetëm për LSI, por edhe për Bashën, pasi opozita dhe 2 liderët e saj treguan përpara shqiptarëve dy çështje të mëdha", tha Vasili. Ndërsa për mundësinë e bashkëpunimit politik me PD-në për zgjedhjet vendore, Vasili tha se ky është një diskutim i dorës së dytë duke theksuar se fokusi i opozitës është lufta ndaj qeverisë që sipas tij po varfëron shqiptarët. "Kur Shqipëria rrezikohet nga një kriminalizim kapilar dhe i skajshëm, në radhë të parë jemi të thirrur t'i japim përgjigje këtyre çështjeve të mëdha politike", tha ai.



Rriten detyrimet e shtetit për energjinë elektrike, ulen të familjarëve

Borxhet ndaj OSHEE arrijnë rekord, 72.8 miliardë lekë

Institucionet, debitorët më të mëdhenj

Ornela Manjani


Institucionet shtetërore, pushtetit qendror dhe vendor kanë akumuluar një borxh të konsiderueshëm ndaj Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike. Sipas të dhënave zyrtare të Entit Rregullator të Energjisë, borxhet ndaj OSHEE në vitin 2017 arritën vlerën më të lartë historike, në 72.8 miliardë lekë me një rritje 3% nga viti i kaluar.

DETYRIMET

Vlera më e lartë e detyrimeve u shënu në vitin 2014 me 71.4 mld lekë. Sipas të dhënave nga Enti Rregullator i Energjisë, ndikimin më të madh në rritjen e borxheve ndaj OSHEE-së e dhanë institucionet dhe ndërmarrjet shtetërore, të cilat rritën detyrimet ndaj OSHEE me rreth 32%, me një vlerë 10.6 miliardë lekë ose 79 milionë euro. Ndërkohë, konsumatorët familjarë kanë ulur më tej detyrimet ndaj Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike me rreth 6 milionë euro vitin e kaluar. Detyrimet totale ranë në 50.7 miliardë lekë nga 51.1 miliardë lekë që ishin më 2016-ën.

FAMILJET

Borxhi i konsumatorëve familjarë ka ardhur në ulje për të tretin vit radhazi, pas një rritjeje galopante që pësu-an këto detyrime gjatë peri-



KONSUMATORËT JOFAMILJARË, BUXHETORË DHE JOBUXHETORË, KËSTE FIKSE MUJORE

- Deri në 300.000 lekë detyrim, me 24 këste.
- Nga 300.000 deri në 500.000 lekë, me 48 këste.
- Nga 500.000 deri në 800.000 lekë, me 60 këste.
- Nga 800.000 deri në 1.000.000 lekë, me 84 këste.
- Mbi 1.000.000 lekë detyrim, me 120 këste.

udhës 2009-2013, kategoritë e tjera të konsumatorëve, ku përfshihen bizneset private dhe shtetërore kanë rritur më tej ekspozimin ndaj OSHEE-së. Borxhi i bi-

zneseve ndaj OSHEE u rrit me rreth 3 milionë euro, duke e çuar vlerën totale të detyrimit në 11.4 miliardë lekë nga rreth 1 miliardë lekë, që ishin detyrimet deri në fund të vitit



Mbështetja financiare për bujqësinë

Peleshi: Pikat e grumbullimit të qumështit, 3 milionë lekë subvencione

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Niko Peleshi bën të ditur se mbështetja financiare nga ana e qeverisë për pikat e grumbullimit të qumështit do të jetë deri në 3 milionë lekë. "Skemë për ndërtimin e pikave të reja të grumbullimit të qumështit dhe pajisjeve të nevojshme në to, masa e mbështetjes do të jetë jo më shumë se 3 milionë lekë. Për makineri dhe pajisje për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në fermat blegtorale, me jo më pak se 10 lopë dhe jo më pak se 100 të imëta, masa e financimit do të jetë jo më shumë se 1 milion lekë. Një rëndësi e veçantë u është kushtuar sistemeve ftohëse të qumështit për pikat e grumbullimit dhe të përpunimit të qumështit, financimi i të cilave do të jetë jo më shumë se 1 milion lekë. Për dorëzimin e qumështit, që plotëson standardet në fuqi, në vlerën 10 lekë për litër në pikat e përpunimit, për fermat me mbi 15 krerë lopë kundrejt futurës tatimore të shitjes dhe raport analizës laboratorike përkatëse", tha ministri gjatë vizitës në qarkun e Gjirokastrës, në një stabiliment modern të përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij. Për ministrin Peleshi, e gjithë politika që po ndiqet do të çojë në garantimin e një tregu të konsoliduar dhe të një hapjeje e sigurt drejt Bashkimit Evropian. "Në tregun shqiptar do të ketë vetëm prodhimet që garantojnë siguri ushqimore, që garantojnë respektim të të gjitha standardeve, sepse vetëm në këtë mënyrë edhe Bashkimi Evropian do të na njohë sistemin tonë të ngritur të sigurisë ushqimore. Do të na hapë dyert për eksport dhe kjo industri do të zhvillohet", tha ministri. Gjatë këtij takimi, ministri është njohur nga afër me proceset që kryhen në fabrikë dhe njëkohsisht me vijimin e punës që është bërë deri tani, kryesisht nga ana e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, në kuadër të aksionit të shpallur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për sigurinë ushqimore. Më shumë se një javë më parë, Ministria e Bujqësisë, nëpërmjet AKU-së shpalli aksionin e inspektimit në distancë, si masë për garantimin e standardeve të sigurisë ushqimore. Për ministrin Peleshi, tashmë ka ardhur momenti që i gjithë tregu të hyjë në një regjim dhe disiplinim, sipas standardeve evropiane, pasi kjo është e vetmja rrugë, që të rriten sektorë të tilla, si ai i prodhimit dhe përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij dhe ai i mishit, pra në tërësi e gjithë ekonomia shqiptare.

Raporti i INSTAT-it për shitjet e biznesit

Rritje e dobët në tremujorin e katërt 2017

Indeksi i shitjeve të biznesit në tremujorin e katërt 2017, duke konfirmuar një tendencë ngadalësimi të ekonomisë shqiptare gjatë gjysmës së dytë të vitit 2017. Sipas të dhënave nga Instituti i Statistikave, në sektorin prodhues indeksi i shitjeve u rrit me vetëm 1.5%, duke ngadalësuar më tej nga rritja 2.2% e tremujorit të mëparshëm. Pasi u mbështet nga rritja e përgjithshme e shpenzimeve gjatë gjysmës së parë të vitit 2017, që përkoj me zgjedhjet, gjysma e dytë e vitit ka sjellë ngadalësim të ndjeshëm. Sipas të njëjtave të dhëna,

mësohet se një ndikim domethënës ka pasur ecuria e dobët e industrisë nxjerrëse, ku shitjet ranë me 7.7% krahasuar me një vit më parë. Kjo sinjalizon një ecuri të dobët të shitjeve në sektorin minier dhe sidomos të naftës bruto. Ndërkohë, industria rripunuese raportoi një rritje të shitjeve me 5.2%. Në ndarjen sipas grupimeve industriale, bie në sy një rënie e ndjeshme e shitjeve të mallrave të konsumit, ndërsa rezultat pozitiv kanë pasur shitjet për mallrat kapitale, të klasifikuara si investime dhe për energjinë. Sektori që vazhdon të ketë ritmet më të larta të rritjes është ndërtimi, por megjithatë, edhe në këtë sek-



tor ritmet e rritjes janë në ngadalësim të dukshëm. Në tremujorin e katërt, shitjet në këtë sektor u zgjeruan me 7.5%, por edhe këtu rritja është larg niveleve dyfishore në tremujorët e mëparshëm. Një tendencë dobësimi shfaqën edhe shumica e degëve kryesore të shërbimeve, duke filluar nga tregtia, ku shitjet me bazë vjetore u rritën vetëm me 1%. Rritjen më të lartë edhe në tremujorin e fundit e regjistruan aktivitetet e shërbimeve të lidhura me turizmin.

Misioni i FMN-së, drejtori takim në AMF

Interesi për strategjinë e zhvillimit të tregjeve, nën mbikëqyrje

Drejtori i përgjithshëm Dekzektiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Ervin Koçi ka pritur në një takim përfaqësuesit e misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar gjatë vizitës së tyre në Shqipëri. Në fokus të takimit ishte edhe përmirësimi i bazës ligjore dhe konsolidimi i kuadrit rregullativ për menaxhimin e mirë të rrezeve, rritjes së transparencës dhe rolit mbikëqyrës të AMF-së dhe mbrojtjes së investitorëve. Koçi njohu përfaqësuesit e FMN-së me zhvillimet e fundit të tregjeve, të cilat



janë nën mbikëqyrjen e Autoritetit, duke u ndaluar kryesisht të tregu i titujve dhe fondet e investimeve. Këto të fundit së bashku me bursën ishin dy çështje të tjera

specifike, të cilat u diskutuan në këtë takim, duke ndaluar më tej edhe të rëndësia e vijimit të forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse. Ndërkohë, nga ana tjetër, përfaqësuesit e FMN-së shprehën interesin e tyre për strategjinë 5-vjeçare për zhvillimin e tregjeve nën mbikëqyrje. Misioni i FMN-së zhvilloi disa ditë më parë edhe në takim me guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, ku diskutuan për një sërë çështjesh që përfshinin zhvillimin makroekonomike, parashikimet për rritjen ekonomike, konsolidimin fiskal.

Prokurori Antimafias, Ettore Cardinali: Droga nisej nga zona e Orikumit

Hajdarmataj: Bashkëpunimi me Italinë çoi në pranga 19 shqiptarë

Operacioni "Shefi" me 43 të arrestuar sjell në Shqipëri agjentë të DIA-s

Ina Allkanjari

Operacioni antidrogë i koduar "Shefi", që shpesh katërroi dy grupe kriminale me 43 anëtarë, mes të cilëve 19 shqiptarë, solli ditën e djeshme në Shqipëri prokurorin Italian, Ettore Cardinali dhe agjentët DIA-s. Në një konferencë të përbashkët për shtyp, prokurori i Krimeve të Rënda, Besnik Hajdarmataj dhe drejtori i Antimafias (DIA) në Rajonin e Puglias në Itali, Cardinali, kanë dhënë detaje lidhur me këtë operacion, të zhvilluar në shtetin fqinj më 14 mars. Kreu i Krimeve të Rënda tha se përgjatë dy viteve këtyre grupe të strukturuar kriminale në fushën e trafikut të narkotikëve, u janë sekuestruar 2.5 tonë kanabis, 1 kg heroinë dhe 1 kg kokainë. "Arrestimi i disa prej këtyre shtetasve shqiptarë në kuadër të operacionit të koduar 'Shefi', është rezultat i hetimeve të përbashkëta të kryera mes Prokurorisë Pranë Gjykatës Shkallës Parë Për Krime të Rënda Tiranë dhe Prokurorisë së Barit në Itali (Drejtoria Rajonale Antimafia). Në vitin 2017 mes këtyre prokurorive është nënshkruar një marrëveshje për krijimin e skuadrës së përbashkët hetimore. Nga shkëmbimi i informacionit mes dy shteteve rezultoi se shtetasit Mariqen Shusha, Donial Drolli, Hamid Seferi dhe Malton Lleshi ishin pjesëtarë të një grupi kriminal që ndodheshin në vendin tonë. Nga bashkëpunimi i forcave dhe provave, u bë i mundur identifikimi i vendndodhjes së tyre dhe u bë arrestimi në operacionin e datës 14 mars", deklaroi Hajdarmataj. Ai zbuloi gjithashtu, se ky operacion kishte në përbërje dhe asistim fizik të oficerëve të policisë gjyqësore pranë DIA-s. "Finalizimi i një bashkëpunimi të suksesshem e të frytshëm. Është hera e parë që në një operacion të tillë asistojnë oficerët të DIA-s që treguan frymën e tyre të bashkëpunimit gjatë punës në terren me oficerë të policisë së shtetit", shtoi Hajdarmataj. Më tej, prokurori i Antimafias së Barit, Ettore Cardinali, njëherazi drejtues i këtyre hetimeve, deklaroi se droga nisej nga zona e Orikumit dhe shpërgoi se përse operacioni u kodua "Shefi" në gjuhën Shqipe. "Ishte emri i një operacioni,



Kreu i Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Besnik Hajdarmataj, prokurori i Barit, Ettore Cardinali dhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu

jo i një personi të caktuar. Edhe sepse gjatë hetimeve janë zbuluar dy organizata të ndara. Njëra që kishte në ngarkim, bënte shefin në Bari dhe një në jug të Barit, ishin dy organizata të ndryshme. Hetimi arriti shumë lart. Nuk u limituam me hetimet vetëm me personazhet që ishin destinacioni i drogës në Itali, por i përqendruam edhe në faktin e personave që nisnin drogën. Për sa i përket zonës së ardhjes, duhet të jetë zona e Orikumit",

deklaroi Cardinali. **DEKLARATA E HAJDARMATAJ**

Me datë 14.03.2018 në vendin tonë dhe në Itali janë nxjerrë urdhër arresti për 21 shtetas shqiptar, prej të cilëve 19 të arrestuar dhe 2 në kërkim, të cilët janë pjesë e grupeve të strukturuar kriminale, të cilat operojnë në fushën e trafikimit të narkotikëve mes dy vendeve, Shqipëri dhe Itali, kryesisht për lëndët narkotike të llojit canabis sativa

ku nga operacionet e kryera në shtetin italian përgjatë viteve 2016-2017, janë sekuestruar 2.5 tonë lëndë narkotike e llojit canabis sativa, 1kg kokainë dhe 1kg heroinë. Nga shkëmbimi i informacionit në mënyrë reciproke dhe të drejtëpërdrejtë me homologët italianë, rezultoi shtetasit Mariqen Shusha, Donial Drolli, Hamid Seferi dhe Malton Lleshi ishin pjesëtarë të një grupi kriminal, i cili vepron te mes Shqipërisë dhe Ital-

ARRESTIMET
"Arrestimi i disa prej shtetasve shqiptarë në kuadër të operacionit të koduar 'Shefi', është rezultat i hetimeve të përbashkëta të kryera me Italinë. Nga shkëmbimi i informacionit, rezultoi se shtetasit Mariqen Shusha, Donial Drolli, Hamid Seferi dhe Malton Lleshi ishin pjesëtarë të një grupi kriminal, i cili vepron te mes Shqipërisë dhe Italisë", deklaroi Hajdarmataj.

isë në fushën e trafikimit të narkotikëve dhe që ndodheshin në vendin tonë. Nga bashkëpunimi i të dhënave dhe provave të përcjella në kohë reale nga autoritetet italiane, si dhe nga puna e përbashkët e oficerëve të policisë gjyqësore pranë Prokurorisë për Krime të Rënda, oficerëve të DIA-s, Bari, Itali si dhe strukturave të Policisë së Shtetit, u bë e mundur identifikimi dhe lokalizimi i vendndodhjes së tyre dhe mbi bazën e ur-



Zbulohet 1 ton kanabis në zonën e Novoselës në Vlorë, droga e papërdorshme

VLORE - Një sasi e madhe droge, rreth 1 ton kanabis është zbuluar ditën e djeshme në zonën e Novoselës në Vlorë. Droga është gjetur në një zonë moçalore në një grupë, por nuk dihet si ka përfunduar aty. Mësohet se lënda narkotike është gjetur në formë të ndryshme, e papërpunuar, gjysmë e përpunuar dhe gati për treg. Mësohet se droga ishte e vendosur në rreth 28 thasë. Vlera e lëndës narkotike mund të shkonte në tregun italian në 1800 euro. Ndërkohë e gjithë sasia e lëndës narkotike është jashtë përdorimit, pasi është dëmtuar nga uji. Droga është pikasur fillimisht nga banorët që kanë lajmëruar policinë.

dhrave të arrestit ndërkomëtar, të përcjellë në rrugën formale nga autoritetet italiane të drejtësisë, konkretisht prokurorisë së Barit (Drejtoria Rajonale Antimafia), u bë dhe arrestimi i tyre në operacionin e datës 14.03.2018. Ky operacion shënon finalizimin e një bashkëpunimi mjaft të frytshëm mes autoriteteve tona të drejtësisë dhe atyre italiane, duke dëshmuar dhe njëherë vullnetin tonë në luftën kundër trafikut të narkotikëve. Gjithashtu, duke theksuar faktin se është hera e parë që në një operacion të tillë, duke qenë pjesë e skuadrës së përbashkët marrin pjesë dhe asistojnë oficerët e Dia-s. Sjellim në vëmendje faktin se hetimet janë ende në vijim, duke premtuar rezultate mjaft pozitive në luftën e përbashkëta ndaj trafikut të narkotikëve mes dy vendeve. Rezultat e deritanishme dëshmojnë qartazi për vullnetin e përbashkët të autoriteteve tona të drejtësisë për të bashkëpunuar në këtë fushë si dhe sigurojnë dhe njëherë kapacitetin tonë profesional dhe njerëzor për të qenë pjesë e hetimeve të përbashkëta për vepra penale me karakter transnacional.

Kokaina në Durrës, Hajdarmataj: Hetime intensive, po bashkëpunojmë me homologë të vendeve ku u tranzitua konteneri



Droga në Durrës e sekuestruar nga policia

Shtetit dhe struktura të tjerat që japin ndihmesë në këto çështje, është një rast që është vlerësuar nga të gjithë në të bashkëpunimit me partnerë dhe homologe të

vendeve ku është tranzituar konteneri. Hetimet janë intensive, kemi përfshirë në hetim oficerët më të mirë që ka Policia e Shtetit dhe Prokuroria e Krimeve të

Rënda po vijojnë hetimet dhe në momentin që do kemi diçka të deklaruar do të jemi këtu para jush", tha prokurori Hajdarmataj. Si kreu i Prokurorisë së Krimeve të Rënda ashtu dhe prokurori italian theksuan faktin se mes dy vendeve ka vullnet për të goditur grupet e trafikut të narkotikëve, ndërsa folën për një numër të madh hetimesh të përbashkëta për trafikimin e drogës nga vendi ynë drejt shtetit fqinj.

Shoqëria Përmbarimore "AFA-2010" sh.p.k
shpall Ankandin për shitjen e pasurisë së paluajtshme:
Pasurisë me Nr. 7/34, e llojit "Apartament", me sip. 50.2 m², dhe sip. truall 19 m², ndodhur në Q. Memaliaj, Tepelenë ZK-2046, në pronësi të Skënder Feta Muka. Çmimi fillestar në ankandin e parë është 537,124.84 Lekë.
Ankandi zhvillohet në datë 19.03.2018, ditën e Hënë ora 15.30 në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "AFA-2010" sh.p.k në adresën Rruga "Sulejman Delvina", Nd.51, H.9, Ap.1, Tiranë. Për më shumë info. Tel:045503458 ose E-mail: shoqeria@perrbarimorafa2010@gmail.com

NJOFTIM ANKANDI
Përmbarues gjyqësor privat Artan Sima zhvillon ankandin sipas datave të mëposhme: Date 16/04/2018, ditën e Hënë, ora 16:00, përfundon ankandi i tri (3) ditëve, për shitjen e pasurive të paluajtshme të llojit "Ara" me sip. 7400 m², e ndodhur në fshatin Blinocë Devoll, në vlerën 414,400 lekë.
Pasuritë janë lene garanci bankare nga debitorit Trashëgimtarëve të te ndjerit/Debitor znj.Bukurije Sulejman Fazo, znj.Mimoza Falmir (Foto) Fazo, z.Nxhimi Foto Fazo, znj. Anxhonda Foto Fazo, znj. Elvira Foto Fazo, znj. Luiza Foto (Kasëbela) Fazo banues në fshatin Blinocë, bashkia Devoll, për detyrimin ndaj kreditorit Fondi Besa Sh.a. me seli në ish Blloku Tiranë. Ankandi zhvillohet pranë zyrës së përmbaruesit me seli lagjen nr.3, Rruga Avni Rustemi, nr.31 k.1, Korçe. Kontakt Cel:0674044666, e-mail. simartan@yahoo.com

NJOFTIM SHITJE ME ANKANDI
ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'
A. Automjeti tip "SKODA", ngjyrë "GRË", vit prodhimi "2009", nr. shasje TMBDG41U4A8840601, me targë "TR 2338 T", në pronësi të dorëzimit z. ALKET SUAD KOTONI, ÇMIMI 120.000 LEKË;
B. Automjeti tip "HYUNDAI", ngjyrë "GRË", vit prodhimi "2009", nr. shasje MALAM51CBAM416803, me targë "AA 714 BH", në pronësi të dorëzimit znj. AIDA LUAN KOTONI, ÇMIMI 130.000 LEKË.
Data e zhvillimit të ankandit do jetë 21.03.2018.
CEL. 0684026666 ; 0693262866

Gjykata e Durrësit ka hedhur poshtë ankimmimim e bërë nga ish-prokurori i rrethit të Elbasanit Dritan Gina, për të marrë nën hetim prokuroren e komanduar të vendit Arta Marku. Në një seancë të zhvilluar prej një ore kryetarja e seancës Joana Qeleshi njëkohësisht kryetare e gjykatës ka argumentuar pretendimet e ngritura nga Gina, para se të ven-



Akuzoi Arta Markun për shpërdorim detyre, gjykata hedh poshtë kërkesën e Dritan Ginës

doste të mos fillonte hetimin penal me akuzën e shpërdorimit të detyrës për Arta Markun. "Ankimmimim është i pabazuar në ligj e në prova. Gjykata e Durrësit vëren se shkaqet nuk plotësojnë elemente të veprës penale për të nisur një proces hetimor.

Si përfundim gjykata nuk pranon ankimmimim, lë në fuqi vendimin e Prokurorisë së Krimeve të Rënda për mosfillim të çështjes hetimorë për palën e paditur Arta Marku"-tha në fund të vendimit të arsyetuar gjykatësja Joana Qeleshi. Qeleshi

arsyetoi se për sa i përket masës disiplinore Gina t'i drejtohet Gjykatës Administrative, për aq kohë sa nuk ka shkak për element të veprës penale. Në seancën gjyqësore paditësi ish-kreu i komanduar i prokurorisë së Elbasanit, prokuror prej 8

vjetësh në Durrës, Dritan Gina bëri dy kërkesa. Ai tha se: "Prokuroria e Durrësit nuk ka kompetencë për kallëzimin tim, sepse kam punuar për një kohë të gjatë këtu dhe se prokurorja e çështjes ka lidhje shoqërore me të paditurën Arta Marku". Gina në seancë ka parashtruar sipas tij disa fakte jo ligjore që janë ndër-marrë për shkarkimin dhe pas shkarkimit nga detyra. **K.A.**

Lihen pas hekurave bashkëshorti i viktimës, kushëriri i tij dhe hoxha

Helmoi vjehrrën me fotoksinë, krimet e rënda lënë në burg 21-vjeçaren

Hoxha: Nuk e denoncova Marjanën për shkak të besimit fetar

Ina Allkanjari

Gjykata e Krimeve të Rënda ka caktuar dritën e djeshme masën e sigurisë 'arrest me burg' për 21-vjeçaren Marjana Cmeta, e cila akuzohet se helmoi vjehrrën e saj me fotoksinë, një vit më parë. Në burg do të qëndrojnë edhe bashkëshorti i viktimës, Lirije Lami, Agim Lami, kushëriri i tij, Arben Saliu, si dhe hoxha Hysen Shehu, të cilët akuzohen për moskallëzim të krimet. Gjatë seancës gjyqësore 21-vjeçarja, nuk dha asgjë shpjegim lidhur me krimin që ndodhi në shtëpinë e saj në zonën e ish-frutikuturës në Kamzë. Ndërkohë Hoxha Hysen Shehu, që ka regjistruar edhe rrefimin e 21-vjeçares Marjana Cmeta për helmimin e vjehrrës, ka thënë në gjykatë se vendosi ta regjistronte për të hequr të gjitha keqkuptimet. "Marjana më erdhi me gjithë familjarët. Unë do t'i bëja rukje (Shërim me kuran kundër syrit të keq dhe magjisë). Për të mos pasur keqkuptime vendosa ta regjistroj rrefimin. Por feja nuk më lejoi ta denoncoj",-ka deklaruar hoxha Hysen Shehu. Ngjarja u zbulua vetëm pasi në duart e prokurorisë ra një regjistrim filmik, i realizuar nga hoxha Hysen Shehu, në zyrën shfaqje të këtij të fundit, ku shfaqej Marjana Cmeta duke rrefyer me detaje mënyrën sesi e kishte kryer krimin makabër. Hoxha shpjegoi para gjykatësit se për shkak të besimit fetar, nuk mund të denonconte rrefimin që bëri besimtarja para tij. Ai tha se Marjana Cmetën e regjistroi me kamera, pasi feja nuk ia lejoi të qëndroje vetëm prej vetëm me një femër dhe në rastin konkret nuk kishte zgjidhje tjetër, pasi 21-vjeçar-



21-vjeçarja Marjana Cmeta

ja nuk pranonte të shoqërohej nga e ëma apo ndonjë person tjetër: Hoxha këmbënguli se nuk e fshehu krimin, pasi për të vuri në dijeni familjarët e të ndjerës, ku i biri, Oltioni informoi prokurorin. Pavarësisht kësaj, ai nuk e bindi gjykatësin Arditi Mustafaj ta lërë të lirë.

HETIMI

Ka qenë dëshmia e Olti Lamit, djalit të viktimës Lirije Lami, para prokurorëve, ajo çka ndihmoi hetimet për zbardhjen e krimet. Olti ka rrefyer se kishte marrë vesh ekzistencën e një videoje, të filmuar nga hoxha Hysen Shehu. Pas dëshmisë së

dhënë, u bë i mundur përgjimi i telefonatave të djalit të Lirijes me hoxhën. Pas përgjimit të bisedave telefonike, u sigurua një vendim gjykate dhe oficerët bënë të mundur sekuestrimin e videos në zyrën e Hysen Shehut, e cila është një ndër provat që rëndon mbi 21-vjeçare Marjana Cmeta, të dyshuar si autore të vrasjes së vjehrrës 48-vjeçare. Mëshohet se pas sigurimit të provave, prokurori Besnik Muçi, kërkoi nga gjykata të miratohen urdhërarrestet për 21-vjeçare Marjana Cmeta, e cila akuzohet për veprën penale "vrasje për shkak të rrethanave familjare".

PROPAGANDA

Dëshmia e hoxhës "Marjana më erdhi me gjithë familjarët. Unë do t'i bëja rukje (Shërim me kuran kundër syrit të keq dhe magjisë). Për të mos pasur keqkuptime vendosa ta regjistroj rrefimin. Por feja nuk më lejoi ta denoncoj",-ka deklaruar hoxha Hysen Shehu.

Hoxha Hysen Shehu ka lajmëruar për ngjarjen e ndodhur bashkëshortin e viktimës Agim Lamin. Gjithashtu, në dijeni ka qenë dhe kushëriri i Lamit, Arben Saliu. Nën akuzë për "moskallëzim krimi", janë vënë në pranga edhe vjehëri i 21-vjeçares, kushëriri dhe hoxha.

Nis vetingu, kalojnë në sitë 36 drejtues të gjykatave dhe prokurorive

TIRANË-Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka nisur vetingun për kryetarët e gjykatave dhe prokurorive. Në një njoftim për mediat bëhet e ditur se është hedhur shorti në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe janë zgjedhur 36 drejtues të gjykatave dhe prokurorisë në rrethe që do të kalojnë sitën e vetingut. Konkretisht kanë filluar procedurat e rivlerësimit për Artan Çupi, Kryetar i Gjykatës së Rrethit Mat; Dritan Seci, Kryetar i Gjykatës së Rrethit Tropojë; Emona Muçi, Kryetare e Gjykatës së Rrethit Pogradec; Enkeledi Hajro, Kryetare e Gjykatës së Rrethit Tiranë; Entela Shedula (Sorra), Kryetare e Gjykatës së Rrethit Kavajë; Halil Vani, Kryetar i Gjykatës së Rrethit Dibër; Isuf Shehu, Kryetar i Gjykatës së Rrethit Kukës; Izet Kadana, Kryetar i Gjykatës së Rrethit Pukë; Joana Qeleshi, Kryetare e Gjykatës së Rrethit Durrës; Ornella Nagelari, Kryetare e Gjykatës së Rrethit Lezhë; Pashk Gjaci, Kryetar i Gjykatës së Rrethit Përmet; Roland Jaupaj, Kryetar i Gjykatës së Rrethit Fier; Esmeralda Çeka, Kryetare e Gjykatës së Rrethit Lushnjë; Skënder Haluci, Kryetar i Gjykatës së Rrethit Vlorë; Sulejman Kurti, Kryetar i Gjykatës së Rrethit Elbasan; Alketa Nushi, Drejtuese e Prokurorisë së Rrethit Kukës; Anton Martini, Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Shkodër; Arben Pasho, Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjirokastrë; Ardian Ylli, Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Vlorë; Ardan Nezha, Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Elbasan; Artan Madani, Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Kavajë; Artan Shtrungza, Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Tropojë; Çlirim Shahini, Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Lushnjë; Donika Çrela, Drejtuese e Prokurorisë së Rrethit Durrës; Dhorina Theodori, Drejtuese e Prokurorisë së Rrethit Korçë; Edison Ademi, Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Sarandë; Elidjana Kasaj, Drejtuese e Prokurorisë së Rrethit Pukë; Eloida Goxhaj, Drejtuese e Prokurorisë së Rrethit Berat; Fatmir Lushi, Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Fier; Hysni Keta, Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Mat; Petrit Çano, Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Krujë; Simon Pashuku, Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Lezhë; Sotir Kllapi, Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Pogradec; Shkëlzen Canaj, Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Dibër; Zeqir Hodaj, Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Kurbin.



SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PËR:

1. **Are** me nr.33/26, e ndodhur ne Karpen, Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.2099,vol.11, fq.202, me sip.2,000 m2, cmimi që do të shitet është **3.942.960** lekë.
2. **Are** dhe trulli me nr.1/88, e ndodhur ne Qerret, Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.3101, vol.9, fq.34, me sip.1.770 m2 cmimi që do të shitet është **9.770.655** lekë.
3. **Are** me nr.33/27, e ndodhur ne Karpen, Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.2099, vol.1, fq.203, me sip.4,050 m2 cmimi që do të shitet është **7.984.494** lekë.
4. **Are** me nr.70/9, e ndodhur ne Qerret, Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.3101, vol.2, fq.106, me sip.6,460 m2 cmimi që do të shitet është **5.094.305** lekë.
5. **Njësi** me nr.15/22+1-N1 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistrimi hipotekor 14/69, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.116 m2 vlerësohet me vlerën e **10.062.434** lekë.
6. **Njësi** me nr.15/22+1-N2 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistrimi hipotekor 14/70, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.91 m2 vlerësohet me vlerën e **7.893.806** lekë.
7. **Njësi** me nr.15/22+1-N3 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistrimi hipotekor 15/71, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.95 m2 vlerësohet me vlerën e **8.240.786**lekë.
8. **Njësi** me nr.15/22+1-N4 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistrimi hipotekor 15/72, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.211 m2 vlerësohet me vlerën e **18.303.221** lekë.
9. **Bodrum** me nr.15/22+1-B e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistrimi hipotekor 130/176, vl.2005-2007, datë 24.09.2007 me sip.609 m2 vlerësohet me vlerën e **14.734.842** lekë.

Të gjitha pasuritë e sipërcituara janë hipotekuar në favor të **Banka Raiffeisen sha**. Ankandi zhvillohet në datë **09.04.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane. Për cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al

PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ

*Permbaruesi gjyqesor privat Ermir Godaj zhvillon ankandin e trette per shitjen e pasurive te paluajshme :

1. Apartament me Nr. pasurie 118/57+2-10, ZK 3292, vol 38, faqe 184, me sipërfaqe 94.5 m², te ndodhur ne Selite, Tirane;
2. Apartament me Nr. pasurie 118/57+2-11, ZK 3292, vol 38, faqe 185, me sipërfaqe 99 m², te ndodhur ne Selite, Tirane;

per shlyerjen e detyrimit ne favor te kreditorit Shoqerise "EDIL-AL-IT" Sh.p.k., ne shumet 67927(gjashtehjete e shtate mije e nentqind e nejetete e shtate)Euro dhe 309225(treqind e nente mije e dyqind nejetete e pese) Leka.

Çmimet me të cilat fillon ankandi i trette jane ne vlerat :

1. Apartament me nr. pasurie 118/57+2-10, ZK 3292, vol 38, faqe 184, me sipërfaqe 94.5 m², te ndodhur ne Selite, Tirane, ne shumet 40484(dyzete mije e katerqind e tetedhete e kater)Euro;
 2. Apartament me nr pasurie 118/57+2-11, ZK 3292, vol 38, faqe 185, me sipërfaqe 99 m², te ndodhur ne Selite, Tirane, ne shumet 41983(dyzete e nje mije e nentqind e tetedhete e tre)Euro.
- Ankandi i trette zhvillohet ne date 03.04.2018, ora 16.00 ne zyrën e përmbaruesit gjyqesor privat Ermir Godaj, Rruga "Abdi Topiani", Qendra Torre Drin, kt.2, nr.33, Tirane, dhe per informacion mund te kontaktoni ne nr.0682099471, 0695370060, email ermirgodaj@zyrapermbarimit.com.

Ja kush mund të aplikojë. Dokumentacioni që duhet të dorëzoni brenda 30 prillit



Voltiza Duro

Studentët e Universitetit të Tiranës, tash më kanë mundësinë që të aplikojnë për bursa brenda datës 30 prill të këtij viti në Bolonja të Italisë. Në faqen zyrtare të UT-së bëhet me dije se këto bursa studimi janë të vlefshme për semestrin e parë të vitit akademik 2018-2019 e do të zgjasin 6 muaj, si për nivelin bachelor ashtu edhe për masterin. Të gjithë studentët e interesuar mund të aplikojnë për degë studimi si: Histori dhe Arkeologji; Filozofi dhe Etikë; Gjuhë e Huaj; Ekonomiks; Shkenca Politike; Psikologji; Sociologji; Gazetari; Kontabilitet; Financë-Bankë; Marketing; Administrim Biznes; Punë Sociale; Drejtësi; Biologji; Biokimi; Kimi; Fizikë; Matematikë; si dhe Statistikë. Këto bursa studimi mbulojnë kompensimin prej 850 euro në muaj për studentët si dhe kostot e udhëtimit, kjo në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës. "Studentët që përfitojnë nga mobiliteti nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.", theksohet në njoftimin e Universitetit të Tiranës.

APLIKIMI NË BACHELOR

Studentët e nivelit Bachelor që janë të interesuar të fitojnë bursën 6 muaj në Universitetin e Bolonjës, duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës gjatë aplikimit. Respektivisht, ata duhet të dorëzojnë një CV në gjuhën angleze apo italiane; një kopje e pasaportës; vërtetim studentit si dhe një

Bursa në Itali për studentët e Universitetit të Tiranës

Njihuni me 20 degët ku mund të kandidoni



Foto ilustruese

MBULIM ME 850 EURO NË MUAJ

Këto bursa studimi mbulojnë kompensimin prej 850 euro në muaj për studentët si dhe kostot e udhëtimit, kjo në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës. Studentët që përfitojnë nga mobiliteti nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës.

listë notash. Gjithashtu, kandidatët duhet të dorëzojnë edhe një letër motivimi në gjuhën angleze apo italiane në varësi të programit të studimit; certifikatën e gjuhës së huaj (Anglisht B1/Italisht B2 në varësi të programit të studimit); si dhe të ashtuquajturën "Learning Agreement". "Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të

origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillojnë në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Ti-

DOKUMENTACIONI

Dokumentet e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit bachelor:

- CV (në gjuhën angleze/italiane);
- Kopje e pasaportës;
- Vërtetim studentit (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);
- Listë notash (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);
- Letër motivimi në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit;
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B1/Italisht B2 në varësi të programit të studimit);
- Learning Agreement;

Dokumentet e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit master:

- CV (në gjuhën angleze/italiane);
- Kopje e pasaportës;
- Vërtetim studentit (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);
- Diplomë e nivelit bachelor;
- Listë notash e nivelit bachelor (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);
- Listë notash e nivelit master (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);
- Letër motivimi në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit;
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B1/Italisht B2 në varësi të programit të studimit);
- "Learning Agreement";

ranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit", citohet në njoftim. Studentët duhet të kenë kujdes gjatë aplikimit në Bolonjë, të përzgjedhin lëndët të njëjta me ato që do të kryen në semestrin e parë në fakultetin e Universitetit të Tiranës, në mënyrë që lëndët

dhe kreditet të njihen kur të kthehen. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që studentët do të zhvillojnë në UT gjatë semestrit të parë, atëherë kur të kthehen sërish, studentët duhet të frekuentojnë që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

FUSHAT E STUDIMIT:

- Histori dhe Arkeologji;
- Filozofi dhe Etikë;
- Gjuhë e Huaj;
- Ekonomiks;
- Shkenca Politike;
- Psikologji;
- Sociologji;
- Gazetari;
- Kontabilitet;
- Financë-Bankë;
- Marketing;
- Administrim Biznes;
- Punë Sociale;
- Drejtësi;
- Biologji;
- Biokimi;
- Kimi;
- Fizikë;
- Matematikë;
- Statistikë

APLIKIMI NË MASTER

Nërkohë, të gjithë studentët që vazhdojnë studimet master e dëshirojnë që semestrin e parë të vitit akademik 2018-2019 ta kryejnë në universitetin e Bolonjës në Itali, duhet të paraqesin dokumentacionin brenda afateve të përcaktuara. Kështu, kandidatët duhet të dorëzojnë një CV në gjuhën angleze apo italiane; një kopje të pasaportës; vërtetim studentit; diplomën e nivelit bachelor ku duhet t'i bashkangjitet lista e notave. Gjithashtu, aplikanti duhet të dorëzojë edhe një listë notash të nivelit master të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze apo italiane në varësi të programit të studimit si dhe një letër motivimi e një certifikatë të gjuhës së huaj. Ashtu si në nivelin bachelor, studentët duhet të paraqesin kontratën "Learning Agreement". Të interesuarit duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mësipërm, dorazi në Rektoriat e Universitetit të Tiranës, pranë Drejtorisë së Komunikimit, Sektorit i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe t'i dërgojnë të skanuara po të njëjtin dokumentacion në emailin iro @ unitiredu.al.

Klosi: E nevojshme për hapjen e sezonit turistik

Nënshkruhet marrëveshja për menaxhimin e ndotjes së detit Adriatik



të menaxhuar shumë herë më mirë derdhen e ujërave të lumenjve në det duke i pastruar ato dhe për të pasur mundësinë që e gjitha kjo të

jetë pjesë e procesit tonë "Clean and Green 2020" pasi është shumë e nevojshme që në hapjen e sezonit turistik këtë vit të kemi një situatë

shumë më të pastër"- tha kreu i Turizmit dhe Mjedisit. Ndërkaq, koordinatori i UNDP-së në Tiranë, z. Brajan vlerësoi marrëveshjen si një shembull të përkryer bashkëpunimi midis dy vendeve që lagen nga e njëjta vijë bregdetare. Projekti i financuar nga qeveria kroate dhe zbatuar nga UNDP ka për objektivi krijimin e një rrjeti të përbashkët për parandalimin dhe reduktimin e rrezeve të ndotjes së mjedisit detar, por edhe menaxhimin e emergjencave.

Nis aksioni i largimit të mbetjeve nga zona e Astirit në Tiranë

Ka nisur aksioni për largimin e mbetjeve në katër zona të ndryshme të kryeqytetit, zona të cilat vitet e fundit kanë pësuar një zhvillim tejet të shpejtë. Bashkia e Tiranës ditën e djeshme, ndërmoi aksionin për largimin e mbetjeve të ngurta dhe grumbujve të plehrave në katër zona të Astirit në kryeqytet, pasi përbënin jo vetëm në burim infeksioni, por njëkohësisht edhe një rrezik aksidentesh. Kjo ndërhyrje ka ndodhur falë mjeteve të rënda të Ndërmarrjes së Punëtorëve Nr. 1 dhe vetë punonjësve që pastruan zonën. Falë këtij aksioni pastrimi jo vetëm që është shmangur rreziku, por njëkohësisht ka nisur puna edhe për rehabilitimin e këtyre shesheve në hapësira çlodhëse për banorët e zonës së Astirit. Ndërkaq, pritet që shumë shpejt Bashkia e Tiranës të nisë punën edhe në zonën e FRESKUT si dhe në zonën e Liqenit të Thatë për pastrimin e mbetjeve të rrezikshme.



Janë konkretizuar bisedimet për shmangien e ndotjes së detit Adriatik, nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjes që parashikon menaxhimin e këtij fenomeni dhe rritjen e sigurisë në det dhe porte. Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi ishte i pranishëm në nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit nga z kryeministria dhe ministria e Europës e Punëve të Jashtme të Kroacisë, Maria Pejcinovic Buric dhe koordinatori i OKB-së në Shqipëri, Brian Williams. Ministri Klosi vlerësoi mbështetjen e dhënë nga qeveria kroate dhe organizata e Kombeve të Bashkuara. "Shpresojmë shumë që kjo të jetë vetëm faza e parë e projekteve për

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 4900 përfituesit

Ornela Manjani

ATP: Dosjet e vitit 1996, pronarët që kompensohen

Ish-pronarët, aplikimet e ezauruara

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 4900 pronarë, të cilëve u është njohur e drejta për kompensim. Dosjet i përkasin vitit 1996. Lista me vlerësimin përfundimtar për subjekte është botuar në faqen zyrtare të Agjencisë së Trajtimit të Pronave. Lista përmban të dhëna lidhur me numrin e vendimit, gjeneralitetet e subjekteve të shpronësuara, sipërfaqja e njohur për kompensim, mangësitë në dokumentacion apo vlerësimin përkatës jepen të detajuara në regjistrin që shohëron këtë njoftim. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit si dhe vlerësimin financiar për çdo dosje.

KOMPENSIMI FINANCIAR

Bazuar në skemën që po ndjek qeveria në zbatim të ligjit të ri për pronat, prioritet do të ketë prona truall, përkundër tokave bujqësore, që do të jepen për kompensim fizik. Pas shqyrtimit të

kërkesave, kompensimi financiar bëhet vetëm për ato subjekte, vendimi i të cilëve është përfundimtar, i ekzekutueshëm ose për kërkesat që nuk janë trajtuar asnjëherë për kompensim. Të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuara financiarisht si tokë truall, do të përfitojnë kompensim financiar nga fondi i kompensimit, deri në masën 50 milionë lekë. Ndërkohë, pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar do të kompensohet fizikisht nga fondi i tokës. Në rastet kur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar për tokën truall rezulton se pjesa e mbetur është deri në 5 për qind më



e madhe se vlera 50 milionë lekë, atëherë subjekti kompensohet për të gjithë vlerën, në rastet kur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar rezulton se pjesa e

mbetur është më e madhe se 5 për qind mbi vlerën 50 milionë lekë, atëherë subjekti për diferencën mbi 50 milionë lekë, kompensohet fizikisht, nga fondi i tokës.

KOMPENSIMI FIZIK

Agjencia e Pronës ka në zotërim 23 mijë hektarë tokë bujqësore, për të cilat ka përfunduar më herët edhe vlerësimi ekonomik, të cilat do të përdoren për skemën e kompensimit fizik. Për ndarjen e kësaj sipërfaqjeje, dy do të jenë kriteret bazë. Kriteri i parë është rendi kronologjik i vendimeve, që do të thotë se, sikurse kompensimi financiar, edhe ky kompensim do të fillojë me vendimet më të vjetra në kohë. Kriteri i dytë lidhet me vendndodhjen e pronës që do të përfitojnë si kompensim fizik. Pra, pronari do të kompensohet me një pronë nga fondi

fizik, e cila gjeografikisht është më afër me pronën që i është njohur për kompensim. Në lidhje me dokumentet që duhet të depozitohen, ato nuk ndryshojnë, por mbeten të njëjta, si në rastin e kompensimit financiar. Ndryshon vetëm formulari i aplikimit, i cili është specifik për secilin rast. Në total janë 26 mijë vendime të formës së prerë, të cilat presin të kompensohen. Bazuar në ligjin e ri, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka nisur një proces të ri rivlerësimi, ku një metër katror tokë do të llogaritet me çmimet e tregut, por zëri kadastral nuk do të jetë ky i sotmi, por ai që ka pasur prona në çastin e shpronësimit.

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesia	Mbimri (Subjekti Kerkues)	VLERESIMI
-------	-------------------------	--------	---------------------------	-----------

(Vijon nga numri i djeshëm)

Durrës	Mehmet Qemali			
Durrës	Virgjit Sallabanda			
Durrës	Ester Bonati			
Tiranë	SHEFKI DISTAFA			
Elbasan	SHABAN TABAKU			1,621,500
Elbasan	SHABAN TABAKU			
Shkodër	Trashg, Thaci			324,000
Tiranë	TIFTIRE PILKATI			
Elbasan	BESNIK ARTUR ISMAIL HOXHA			3,867,478
Elbasan	SHAHE PEQINI			1,723,140
Dibër	Shemsi Driçi			
Tiranë	EDIP PUSTINA			76,264,297
Tiranë	MEVLUDE TURTULLAJ			EZAURUAR
Tiranë	ARIF HOXHA			3,347,538
Tiranë	KOZMA THEOFAN QORRI			12,623,657
Korçë	Qazim Pepi			
Berat	Minella Gushali			
Elbasan	EDMOND KOSTANDIN MANUSHI			1,093,280
Elbasan	FATUSHE VYSHKA			EZAURUAR
Elbasan	BASHKIM GJERGJI			EZAURUAR
Elbasan	MITHAT ÇOPIJA			316,350
Shkodër	Sabri Miloti			10,145,090
Shkodër	Mine Maraska			-
Shkodër	Zyber Derguti			
Shkodër	Kujtim Ferhati			1,089,408
Shkodër	Filip Fiqej			612,792
Shkodër	Ahmet Riza Puka			
Tiranë	HAXHIRE SATA			
Tiranë	SELMAN KARAPICI			28,126,980
Tiranë	ALBERT SHANI			2,678,760
Elbasan	Aridian Harja			
Berat	Hekuran Merdanit			4,077,280
Lezhë	Llesh Ded Gjergji			
Shkodër	Hasie Muca			2,310,147
Tiranë				EZAURUAR
Tiranë	LULZIM MEMA			EZAURUAR

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesia	Mbimri (Subjekti Kerkues)	VLERESIMI
-------	-------------------------	--------	---------------------------	-----------

Tiranë	REXHEP DEMNERI			3,482,388
Tiranë	VANGJEL E STAVRI ÇOKA			
Durrës	Jusuf Falli			
Durrës	Pal Lala			
Vlorë	Abedin Ahmeti			752,000
Durrës	Sadik Cakri			
Vlorë	trashëgimtarët			EZAURUAR
Vlorë	Napolon Lepuri			-
Durrës	Vasil Gjergo			
Durrës	Mehmetali Basha			
Durrës	Jorgaq Stasi			
Durrës	Tomorr Lazo			
Durrës	Nadire Vinçina			
Vlorë	Dhimitër Kreko			-
Lezhë	Vokerr Lekgega			
Durrës	Agim Dollaku			
Korçë	Petrit Rushiti			6,000
Berat	Zylfie Dervishi			
Durrës				
Berat	LACI XHAMO			
Vlorë	Merita Nauni			
Korçë	Mendo Toska			577,600
Korçë	Refije Mullaj			
Korçë	Nikolla Vano			
Korçë	Kamber Shahollari			1,040,000
Korçë	Rapo Koca			60,000
Korçë	Barjam Buna			919,600
Korçë	Ali Serani			261,500
Korçë	Hamdi Ajdini			
Korçë	Izet Mustafa			450,000
Korçë				
Korçë	Xhevit Meçolli			555,200
Korçë	Muhamet Xhuti			
Korçë				
Korçë				EZAURUAR
Shkodër	Xhelal Dragusha			23,394,822
Shkodër	Shefqet Bushati			3,267,180

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesia	Mbimri (Subjekti Kerkues)	VLERESIMI
-------	-------------------------	--------	---------------------------	-----------

Shkodër	Beqir Mushani			17,112,200
Shkodër	Xhevat Miloti			867,833
Shkodër	Beqir Krymi			8,067,180
Shkodër	Eljaz Hysa			
Tiranë	ALI NELKU			2,009,070
Vlorë	Amalia Irakli Spiro			286,880
Vlorë	Zija Rapaj			
Vlorë	Bajram Hasani			EZAURUAR
Vlorë	Edmond Mëzi			1,020,000
Vlorë	Emil Shiroka			
Korçë	Merjeme Bashllari			945,520
Shkodër	Daut Hasi			7,700,490
Vlorë	David Matathia, Mateo Matathia, Samuel M			EZAURUAR
Vlorë	Feti Deromema			
Durrës	Riza Seseri			
Durrës	Adem Topciu			
Durrës	Muharrem Rustami			
Shkodër	Taip Bejto Zeneli			
Tiranë	SALI HUTA			6,342,860
Durrës	Mustafa Rexha			
Durrës	Xhemal Garori			
Durrës	Stefan Herzegh			
Durrës	Andon Belba			
Durrës	Eqerem Musta			
Durrës	Adriana Frashëri			
Durrës	Ferik Jonuzi			
Elbasan	MALIQ KOKONOZI			
Korçë	Gurali Dervishllari			
Korçë	Petrof Kadilli			65,569
Korçë	Avni Biba			EZAURUAR
Korçë	Eliana Gusho, Irini Gusho, Roksani Gusho			EZAURUAR
Tiranë	AGIM KOKONOZI			
Tiranë	AJKE ADEMI			EZAURUAR
Tiranë	HASAN TABAKU			14,599,242
Tiranë	SYRRIA KAZAZI			703,175
Tiranë	RINKA PETI			9,198,650
Tiranë	Asllan Vrapci			
Tiranë	HIQMET KONICA			8,773,155
Tiranë	ZYBEITE LLAGAMI			

PROTESTA

Cirkut i hiqet statusi kombëtar? Artistët: Do hyjmë në grevë urie

Fatmira Nikolli

Ndryshimi i ligjit për Artin do të lërë pa status Cirkun Kombëtar. Me miratimin e ndryshimeve në ligj, e ardhmja e cirkut duket e paqartë. Veç kësaj, prej vitesh truallit ku ndodhet Cirku, pranë Qendrës Kulturore "Tirana", është truall me probleme ligjore. Së shpejti ai pritet t'i dorëzohet pronarit dhe dorëzimi është shtyrë prej disa kohësh nga Ministria e Kulturës, me premtimin se për artistët e institucionin do të gjendet një zgjidhje. Dje, artistët e Cirkut janë mbledhur në një konferencë që paralajmëronte protesta dhe shkak për këtë u bë si ligji i artit, edhe një VKM e 7 marsit.

VKM DHE STATUS

Një VKM e së mërkurës së 7 marsit, kalon në pronësi të Bashkisë së Tiranës, një pronë që pritet t'i jepet Cirkut Kombëtar. VKM-ja ka për qëllim "transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore". Ajo përcakton "Kallimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të njësisë administrative Tiranë, të pastrurive nr.8/638, me sipërfaqe 2.400 (dy mijë e katërqind) m², dhe nr.8/637, me sipërfaqe 23 (njëzet e tre) m², me vendndodhje në zonën kadastrale nr.8270, indeks harte TR-U-10, sipas formularit dhe hartave treguese bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim ushtrimin e aktivitetit social-kulturor të Cirkut të Tiranës".


Çka do të thotë se Cirkut i jepen 2423 metra katrorë pranë stadiumit "Dinamo".

Për sa më lart, në dokument, Cirku Kombëtar del me emrin Cirkut i Tiranës, edhe pse statusi "kombëtar", nuk mund të hiqet me një vendim për çështje trualli.

"GSH" ka kërkuar nga Ministria e Kulturës të dijë nëse vendimi në

Truallit në qendër i del pronari, çadra do zhvendoset te liqeni

Një VKM e bën Cirkun Kombëtar, Cirk të Tiranës, artistët kundër



Në foto:
Shfaqje nga Cirku

fjalë e heq Cirkun Kombëtar nga qendra për ta dërguar pas stadiumit, por prej asaj dite nuk ka marrë ende përgjigje.

Ndërkaq, përmbaruesit dhe artistët e Cirkut Kombëtar në Tiranë janë përplasur disa herë. Artistët nuk kanë lejuar zbatimin e urdhrimit ekzekutiv, sipas të cilit 409 metra katrorë nga hapësira ku është vendosur çadra e cirkut i kalojnë me vendim gjykatë një subjekti privat. Nga ana tjetër, përmbaruesit pretendojnë se prej 2 vitesh po bllokohen në ekzekutimin e urdhrimit të Gjykatës së Tiranës, që daton në dhjetor të 2014-ës. Ministria e Kulturës pati premtuar zgjidhjen përfundimtare të problemeve të cirkut, që kur në krye të saj erdhi Mirela Kumbaro.

Pas kaq vitesh shtyrje, duke



Në foto:
Konferenca e djeshme e Cirkut

qenë kretësisht jashtë vëmendjes së Ministrisë së Kulturës në 5 vitet e fundit, e vetmja zgjidhje e gjetur nga ministria për Cirkun, duket se

është heqja dorë prej tij. Për sa më lart, dje artistët u mbledhën për ta kundërshtuar hapur: "Nga Cirk Kombëtar (VKM) e quan Cirk të Ti-

ranës, në një kohë kur Cirk Kombëtar e ka marrë këtë status nga dispozita ligjore datë 18.11.2010 dhe është miratuar nga 3 të katërtat e Parlamentit. Dhe nuk ndodh kurrë që një akt nënligjor, siç është VKM të prevalojë mbi dispozitat ligjore", tha përfaqësuesi i Sindikatës së Pavarur të Artistëve të Shqipërisë, Rudi Sata.

Artistët thanë se, edhe pse kanë kërkuar sqarim nga ana e Ministrisë së Kulturës, nuk kanë marrë asnjë përgjigje.

Pas Satës, kryetari i Sindikatës të Artistëve të Cirkut, Julian Kazazi, paralajmëroi përshkallëzim të protestës. "Si mund ta citojë Këshilli i Ministrave 'Cirkun e Tiranës' pa marrë një vendim Parlamentar, për heqjen e këtij statusi kombëtar? Jemi të vendosur të protestojmë e të reagojmë deri në fund, që nga bojkotimi i shfaqjeve e deri në javën që vjen e deri në grevat e urisë. Artistët e Cirkut janë të vendosur që statusin kombëtar nuk e lëshojnë. Ne në ministri na kanë thënë se nuk kanë fonde të na mirëmbajnë". Megjithatë kërkesën e gazetarëve për një reagim mbi kërkesat e artistëve të Cirkut Kombëtar, Ministria e Kulturës, as ditën e djeshme nuk është shprehur.

RIKTHEHET "QIELLI I HESHTUR" NË "METROPOL"

Këmbëngulja, energjia, pasioni dhe vizioni e bëjnë një vajzë nga Bostoni të ndjekë ëndrën e saj. Historia mahnitëse e jetës së astronomes Henrietta Levit, (një nga astronomet e para në Harvardin e 1900-ës) dhe kolegeve të tjera që realizuan hartën e yjeve në univers, përkushtimi i të cilave ndryshoi përgjithmonë mënyrën se si ne kuptojmë qiejt dhe Tokën.

"Qielli i Heshtur", një komedi romantike, gjysmë biografike e shkruar nga Loren Gunderson, është shfaqje të cilën teatri "Metropol", me regji nga Armeta Demaj, e rikthehen sërish në skenë pas kërkesave të shumta të publikut, në datën 21 mars, ora 19:00. "Qielli i Heshtur" është një ndodhi njerëzore, që i flet shoqërisë, dje dhe sot. Është një vepër, e cila flet për marrëdhëniet e familjare, besimin, fuqinë e mendjes dhe shpirtit, mbështetjen, solidaritetin dhe këmbënguljen për të kërkuar dritë në thellësitë e pandriçuara. Një vepër që eksploron marrëdhënien mes muzikës dhe matematikës, shkencës dhe besimit. Kjo shfaqje rivjen në



"Metropol" si një vlerësim për kontributin e këtyre grave që bënë histori në botë dhe veprën e përjetshme që na lanë pas. Henrietta Leavitt (1868-1921), një astronom amerikane, e cila ia doli të bënte një nga zbulimet më të rëndësishme të kohës, që ndryshoi përgjithmonë botën e shkencës dhe astronomisë e gjithashtu perceptimin tonë mbi qiejt dhe tokën. Historia e vërtetë e astronomes së shekullit të 19-të, Henrietta Leavitt, humton vendin e një gruaje në shoqëri gjatë një kohe me zbulime të mëdha shkencore, kur ide të grave hidheshin poshtë derisa burrat të pohanin për ta. Kur Henrietta Leavitt filloi punën në Observatorin e Harvardit në fillim të viteve 1900, nuk i lejohej të prekte teleskopin apo të shprehte një ide origjinale. Këmbëngulja dhe hu-

lumtimi i saj solli përparime të shumta brenda fushës, efektet e të cilave shtriheshin edhe përtej jetës së saj. Ajo zbuloi një mjet për të renditur madhësitë e yjeve, duke përdorur pllaka fotografike, të cilat u bënë standard në këtë fushë. Leavitt gjithashtu zbuloi një mjet me të cilin astronomët u bënë më të aftë për të matur me saktësi distancat galaktike. Ndërsa në kohën e saj të lirë, ajo përpiqet të matë dritën dhe distancën e yjeve. Henrietta gjithashtu duhet të marrë masën e jetës së saj në Tokë, duke u përpjekur për të balancuar përkushtimin e saj ndaj shkencës me detyrimet e familjes dhe mundësinë e për t'u dashuruar.

Interpretojnë: Armela Demaj, Jonida Beqo, Sonila Kapidani, Shkelzen Berisha, Verjana Abazaj; Skenografia: Klodjana Beqiraj; Efektet Speciale: Elian Stefa; Koreografia: Donald Martini; Identiteti vizual: Vincenzo Gianattasio; Trailer: Ergys Meta. Shfaqja do të ngjitet në skenë në datat 21, 22, 23, 24, 25, 28, 29, 30, 31 mars, 1, 4, 5, 7, 8 Prill, ora 19:00 në teatrin "Metropol".

THEMELOHET INSTITUTI I TEATRIT EKSPERIMENTAL

Dje në sallën "Goethe" të Teatrit Kombëtar Eksperimental në një takim mes artistësh, studiuesish, botuesish dhe medias, u themelua Instituti i Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" dhe u prezantua botimi i parë i këtij instituti: Stanislavski - SISTEMI (Puna e aktorit me veten), përkthyer dhe përgatitur nga Mehmet Xhelili. Ky libër botohet me mbështetjen e Fondacionit "F.S.Noli".

Instituti i TKEKS është një platformë e kërkimit dhe e shprehjes krijuese në fushën e teatrit, performancës artistike, të ndikimit poetik dhe e teorie mbi teatrin eksperimental.

Instituti duke qenë një takim i hapur mes autorëve, përkthyesve, regjisorëve, aktorëve, skenografëve, kostumografëve, muzikantëve, koreografëve, dramaturgëve, regjisorëve të ndriçimit, fotografëve dhe analistëve të artit bashkëkohor, ka si qëllim ndërtimin e gjendjeve, depozitimin e kërkimeve, interpretuesve dhe edukative të veprave dhe shfaqjeve, kultivimin e teorie radikale, aktit artistik me një grup të gjerë shoqëror që do të kapërcejë pengesat dhe kufizimet komerciale dhe kulturën e regjimit dominues. Në çdo projekt të institutit të TKEKS ekziston përpjekja për një eksperiment, një procedurë provë, një pyetje.

"Vendi i punës" ose është një festë, ose nuk ekziston, asnjë nuk të detyron që të jesh akt. Akti teatral bëhet një fushë shprehjeje e jetës kolektive, të bashkësisë së lashtë, të respektit, dashurisë, ndihmës reciproke dhe singleritetit të shpenguar midis të gjithë zbatuesve. Hierarkia zhduket. Marrëdhëniet bëhen të vërteta, nuk ekzistojnë kompromiset dhe detyrimet e përditshme të jetës sonë ua lënë vendin angazhimeve të ndërgjegjshme, zgjedhjeve personale dhe vendimeve kolektive.



BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 601

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE

Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtunë 17 mars 2018



BENIADA NISHANI: JAM E DASHURUAR, POR AI ESHTË XHELOZ

"Do të më pëlqente të krijoja familje para se të mbushja 30 vjeç"



"GJEJENI ME KE NGJAN!"

BUKUROSHJA
E NJOHUR
ZBULON NE
FOTO IMAZHIN E ZAHO RAMES



AKSIDENTI



ISH-FITUESI I BIG
BROTHER,
PËRFUNDON NË
KARRIGE ME RROTA

Linda Rei godet sërish, poston foto topless në rrjetin social

Të gjithë tashmë janë të njohur me transgjinioren e parë shqiptare, Linda Rei e cila është shpesh në vëmendjen e mediave rozë. Pas bujës së fundit që bëri me lajmin e ndarjes nga biznesmeni zvicerian, Linda ka vendosur t'i kthehet seriozisht pasionit të saj për modeling. Dhe këtë gjë e shohim shpesh në daljet e saj të herë pas herëshme në faqen e saj në "Instagram" apo edhe "Instastory" ku nuk heziton të hedhë foto provokuese. Edhe kësaj radhe Linda ka hedhur një foto ku ka pozuar topless e shtrirë në krevat. Mesa duket Lindës i pëlqen të pozojë me foto provokuese pavarësisht komenteve negative, të cilat i janë bërë më parë, gjë që ka çuar Lindën edhe në heqjen fare të tyre nga "Instagrami".



Eugent Bushpepa prezanton versionin përfundimtar të këngës përfaqësuese të Shqipërisë në 'Eurovision 2018'

Fituesi dhe përfaqësuesi i vendit tonë, Eugent Bushpepa, do të marrë pjesë këtë vit në Eurovision me këngën "Mall". Në momentin që Eugenti u shpall fitues në "Festivalin e 56-të të Këngës në RTSH", ai tha se donte ta këndonte në shqip këngën e tij fituese. Dhe vërtetë që ashtu ndodhi. Jo më larg se dje ai prezantoi versionin përfundimtar të këngës dhe gjithçka ishte shqip. Në këtë version të ri vihet re një ndryshim i lehtë notash, por kënga vazhdon të jetë po njëjllë e fuqishme. Në kanalën zyrtar të 'Eurovision Song Contest' në 'Youtube' kënga ka marrë komente shumë pozitive dhe në veçanti është komplimentuar Eugenti për zërin e tij të pakrahasueshëm. Ai do të këndojë në gjysmëfinalen e parë të Festivalit 'Eurovision', më datën 8 maj.

Aksidentohet ish-fituesi i "Big Brother", përfundon në karrige me rrota

Me siguri që ju kujtohet fituesi i spektaklit "Big Brother Albania 8", Vesel Kurtishaj. Ai është djaloshi nga Prizreni, i cili u bë i njohur edhe si prezantues, falë disa programeve që ka drejtuar në të kaluarën. Veseli është një emër mjaft i ndjekur në rrjetet sociale, në të cilat është shpesh aktiv. Ditë më parë, mediat raportuan për një lëndim të tij në gju, ku si pasojë ai u shtrua në spital. Së fundmi, Veseli ka publikuar një fotografi në llogarinë personale në "Instagram", ku shfaqet në një karrige me rrota, dhe afër mban patericat. Në statusin e tij, ai u shkruan ndjekësve se gjendja e tij tani është mirë, dhe së do të shërohet së shpejti.



Vijojnë thashethemet për shtatzëni, por “përgjigjja” e


XHENSILËS

do t’ju lërë pa fjalë

Prej kohësh nëpër mediat rozë qarkullon lajmi i se bukuroshja Xhensila Myrtezaj është në pritje të fëmijës së saj të parë. Gjithashtu, jo më larg se java që kaluam, kanë qenë pikërisht fansat ata që e kanë filmuar bukuroshen duke kënduar ku ajo shfaqej e veshur me një xhakëtë të zezë, por që binte shumë mirë në sy barku i fryrë. Gjithashtu, edhe në daljet e tjera ku bukuroshja kishte veshur pantallona, vihej re qartë barku i rrumbullakosur. Mirëpo këto reagime të mediave rozë mesa duket nuk e kanë shqetësuar bukuroshen apo edhe partnerin e saj, humoristin Besart Kallaku. Përkundrazi, jo më larg se dje, në një nga pushimet e saj të radhës në Itali, Xhensila poston disa foto e veshur me një xhup të Max Marës të zi. Por ajo që bie më tepër në sy, është pikërisht photoshopi i bërë mbi fotot e shkreputa ku edhe kësaj radhe këngëtarja mundohet të mbulojë të vërtetën. Ende



nuk e dimë se çfarë e shtyn Xhensilën të mbulojë një fakt të tillë kaq të bukur. Gjithsesi herët a vonë do ta pranojë, jemi të sigurt!



Pasi prish marrëdhëniet me menaxherin e saj, vjen reagimi i parë i **ENCËS**

Mesa duket po vijojnë ende “terset” në karrierën e këngëtares së njohur Enca Haxhia. Në fillim u shkëput nga bashkëpunimi i suksesshëm, i cili i dha

edhe një “boom” të madh në muzikë, me reperin e njohur Noizy, ndërkohë që jo më larg se dje ka qenë vetë menaxheri i saj, Kastriot Berisha, i cili thotë se nuk do të pranojë më ta përfaqësojë këngëtares. Nuk është hera e parë që ajo akuzohet për mosmirënjohje nga bashkëpunëtorët e saj në rrugën e muzikës dhe ende nuk dihet shkaku i vërtetë i një ftohje të tillë të marrëdhënieve mes tyre, pasi dimë vetëm një anë të medaljes. Por nuk ka vonuar reagimi i vetë këngëtares pas postimit që ish-menaxheri i saj bëri në “Facebook”. Në faqen e saj në “Instagram”, këngëtarja poston një foto e veshur vetëm me të brendshme të kuqe dhe një robdeshambër përsipër ku duket mjaft provokuese. Mesa duket një lajm i tillë nuk i ka bërë përshtypje këngëtares, e cila është e vendosur të çojë para turin e saj në SHBA dhe në Europë. Por, gjithashtu, pasuan edhe postimet në “Instastory” ku ajo shfaqet duke qarë në një foto, e cila mesa duket e shkëputur nga ndonjë klip mban mbishkrimin: “Kurrë nuk ki me dit sesa vuaj”. Të jetë ky thjesht një promovim i këngës “Dua”, që Enca do të nxjerrë së shpejti apo ndonjë reagim ndaj krisjes që pati me Berishën?





Ajo është padyshim një nga vajzat më të lakuara në mediat rozë dhe kjo jo vetëm për shkak të lidhjes së saj të gjatit me ish-presidentin shqiptar, Bujar Nishani. Beniada Nishani është gjithashtu një nga modelet shqiptare mjaft të njohura në Itali. Ajo ka qenë shpesh pjesë e kopertinave të revistave të suksesshme në Itali. Së fundmi ajo është bërë kryefjalë e mediave sportive të “Sport Mediaset”, ku shfaqet në foto duke veshur vetëm fanellën e Juventusit. Në një intervistë ekskluzive për “Bluetooth” të “Gazeta Shqiptare”, Beniada flet për eksperiencën e saj lidhur me modelingun me të brendshme ose nudo, si edhe faktin që së shpejti do ta shohim në një film të realizuar së fundmi. Për çfarë do të hiqte dorë Beniada nga modelingu?



Rrëfëhet Beniada Nishani: Jam e dashuruar, por ai është xheloz

Pozon toples pas fitores së Juventusit, flet mbesa e Bujar Nishanit: Ja për çfarë do të hiqja dorë nga modelingu

“Do të më pëlqente të krijoja familje para se të mbushja 30 vjeç”

Pamela Aliaj

Prej kohësh ke nisur botën e modelingut. Me çfarë projekti jeni duke u marrë tani?

Në këtë moment, projekti im më i rëndësishëm është të çoj deri në fund rrugën e nisur lidhur me studimet për aktrim. Është një gjë shumë impenjative, që më merr shumë kohë për projektet e tjera.

Cila revistë ju ka propozuar për kopertinë? Sa ka qenë shifra më joshëse?

Si plan, pas filmit në të cilin mora pjesë, kam shumë propozime dhe bashkëpunime për të ardhmen. Mbase edhe revista “Play Boy”, do ta vlerësoj si mundësi së bashku me agjencinë time.

A ka të dashur Benia-



da? Nëse po, a është xheloz ai për profesionin tuaj?

Në këtë moment në jetën time është një person, i cili është xheloz për mua, aq sa jam edhe unë për të. Xhelozia përfaqëson interesin për personin. Pa të do të ishte e kotë. Por duhet kontrolluar pa e ekzagjeruar, në të kundërt do të preferoja të isha sërish 'single'.

Cili është incidenti më i sikletshëm që ka ndodhur prapa kuintave të një 'fotoshooting'?


Kam punuar gjithnjë me profesionistë të mëdhenj dhe nuk kam pasur asnjëherë probleme. Por incidente të vogla ka në çdo punë, mjafton të dish t'i evitosh.

Për çfarë do të hiqte dorë Beniada nga modelingu?

Kjo karrierë që jam duke ndjekur ka një kohëzgjatje më të shkurtër se të tjerat, nuk zgjat gjithë jetën. E bukura e çdo projekti është evolimi. Mund të hiqja dorë nga kjo punë vetëm për një dashuri të madhe, vetëm nëse personi tjetër mund të ketë mundësi të investojë në projektet e tjera të mija. Në të kundërt, si mund të jetoj pa punuar?! Nëse me dashurinë paguhet qiraja dhe faturat, atëherë me shumë kënaqësi heq dorë. (Qesh) Unë jam për pavarësinë individuale. E rëndësishme është të respektojmë njëri-tjetrin. Duhet të pretendojmë gjithnjë nëse ia lejojmë vetes. "Bisogna pretendere se ce lo si può permettere".

Së fundi, doja të nënvizoja artikullin e shkruar në "Sport Mediaset" lidhur me fotot e tua me bluzën e Juventusit. Jeni tifozë e çmendur e..?

Kam qenë gjithnjë e apasionuar pas futbollit dhe do



të doja të mbështesja dhe unë Juventusin tim. Që në momentin që kam postuar fotot e para, u shënuan një numër i madh golash, njëri pas tjetrit. Uroj që të sjell pak fat.

Ju vijoni gjithashtu edhe shkollën për aktrim. A keni pasur propozime

që të jeni pjesë e ndonjë filmi? erotik?

Po, siç thash edhe më parë, kam marrë pjesë në një film shumë të rëndësishëm, që do të dalë në kinema shumë shpejt. Erotik? Nuk më intereson aspak!

Në postimin e fundit të bërë në "Facebook" flis-

nit për ndryshime. Për çfarë bëhet fjalë konkretisht?

Ndryshimet janë simbol i rritjes. Do të më pëlqente të krijoja familje para se të mbushja 30 vjeç. (Qesh). Ku i dihet, të shohim.

Gjithashtu, më parë keni përmendur nëpër media të se do t'ju pëlqente të ishit pjesë e një 'show' të madh televiziv, siç është "Big Brother VIP Albania". A dëshironi sërish të jeni pjesë e këtij formati?

Nëse do të zgjidhja, do të preferoja të merrja pjesë këtu në Itali, për shkak të çmimeve që jepen.

A ju kanë propozuar diçka?

Për momentin nuk më intereson "Big Brother Albania". Nuk do ta bëja, sepse nuk do të më sillte suksesin profesional që dua. Pastaj nëse "Big Brother Albania" më paguan 500 mijë euro, kush s'do të pranonte? (Qesh) Bëj shaka! Nuk besoj se do refuzonte njeri. Të paktën s'do të punoja më.





Kishte mbetur enigmë, por tani mund ta shihni të gjithë, ja fytyra e vërtetë e djalit të kryeministrit

“Gjejeni me kë ngjan!”, bukuroshja e njohur zbulon në foto imazhin e ZAHO RAMËS



Nuk e dimë nëse është tendencë e viteve të fundit, por shumë nga personazhet e njohur apo të quajtur ndryshe “VIP”, nuk preferojnë të shfaqin fytyrën e fëmijëve të tyre të vegjël. Kjo për shkak se nuk duan që ata të jenë në qendër të vëmendjes edhe kur nuk janë ata që i nxjerrin në foto ose edhe mbase për të mos i njohur njerëzit e thjeshtë kur mund të kenë mundësinë t'i shohin në jetën e përditshme. E ndërsa kjo gjë nuk është bërë ende e qartë, dikush ka vendosur që për të gjithë ne që jemi kuriozë, të shfaqë më në fund fytyrën e vogëlushit të kryeministrit, Zaho Rama. I keni vënë re me shumë mundësi fotot që poston kryeministri duke e nxjerrë fëmijën me kurriz dhe mos dashur që dikush të fokusohet e ta njohë me fytyrën e tij të vërtetë. Dhe askujt nuk do t'ia merrte mendja se do të jetë pikërisht bukuroshja Rashel Kolaneci, ajo që do ta zbulonte fytyrën e vërtetë të vogëlushit Zaho. Rashel



Kolaneci që nga momenti që është larguar nga “Xing me Ermalin”, e kemi parë gjithnjë e më shpesh në “Procesi Sportiv”, një program ky për të cilin është aluduar se ndoshta shumë shpejt ajo do mund të marrë postin e bashkëprezantueses krah Edi Manushit. Ndërkohë që nëpërmjet një posti të bërë në faqen e saj në “Instagram” ajo ka hedhur një foto të fytyrës së vërtetë të mbuluar me aq fanatizëm nga vetë kryeministri për kaç kohë. “Gjeni personazhin që ngjason me Zahon, engjëllin e vogël”, shkruan bukuroshja në postimin e saj. Dhe mesa duket ndjekësit nuk e njohin të gjithë fytyrën e vogëlushit dhe nuk e dinë se kush është Zaho, dhe kjo vihet re edhe nga komentet e tyre. Por ka qenë pikërisht një nga njerëzit e njohur të Rashelit, e cila e ka zbuluar enigmën e fotos. Ajo ka thënë se Zaho, djali i kryeministrit i ngjan pikërisht Eniel Kolanecit, kur ka qenë i vogël, tashmë një avokat dhe familjar i Rashelit. Foto të tilla vështirë të kalojnë pa u vënë re duke qenë se flasim për djalin e kryeministrit.

Flet ish-banorja e "Big Brother": Jam e dashuruar dhe e lumtur

Edhe pse ka kohë që nga dalja e saj nga "Big Brother", ajo vazhdon të jetë në vëmendje të mediave rozë. Bukuroshja nga Shqipëria, Rike Roci u përfol për ndarjen dhe rikthimin tek ish-partneri i saj DJ italian që mesa duket nuk përfundoi me një "happy ending". Por në një intervistë për programin "Pasditja ime", të gazetarit Eraldo Rexho, Rikja ka thënë se e ka harruar të shkuarën dhe është duke jetuar një marrëdhënie të re. "Jam e dashuruar dhe e lumtur, kaq mund të them për momentin", ka thënë bukuroshja nga Durrësi. Rikja, edhe pse tashmë ka ndërtuar jetën e saj në Itali, është rikthyer në Shqipëri për të marrë pjesë në spektaklin "Dancing with the stars", që pritet të fillojë së shpejti në "Vizion Plus".



Pas ardhjes në jetë të Klohe, Zaimina rrëfen për jetën e re: Disa gjëra Klodit nuk i pëlqejnë

Pas lindjes së vogëlushes Klohe, ashtu siç ndodh me të gjitha nënat e reja, edhe me Zaiminën kanë ndryshuar oraret, gjumi, ritmi i ditës e gjithçka që lidhet me të bijën. Për momentin, ajo i është përkushtuar vetëm vogëlushes duke lënë mënjanë të gjitha angazhimet e tjera në biznes, por edhe në jetën artistike. E ftuar në një lidhje me Skype në Pop Culture pasditen e djeshme, Zaimina tregoi edhe disa detaje për jetën e re si nënë. E pyetur se si po e përjeton ai këtë periudhë që kur është bërë baba, Zaimina përgjigjet: "Klodi, ka disa gjëra që nuk i pëlqejnë...", por nuk është fjala aq për qëndrimin më shumë në shtëpi, as për raportin intim me Zain: "Kufizohet tani nga disa gjëra që ndodhin te mami..." - shton ajo, pa specifikuar cilat janë ato që Klodit nuk i pëlqejnë. Natyrisht, edhe Klodi duhet të kuptojë se gjatë kësaj periudhe nënat e reja bëhen më emocionale, ndaj për to duhet më shumë kujdes. Siç rrëfen Zaimina, shumë gjëra që ndodhin me vogëlushen, as ajo vetë nuk i ka ditur, por po i mëson bashkë me të: "Edhe unë po mësohem me të, nuk e kisha menduar si do të ishte, po mësohemi të dyja me njëra - tjetrën", ka thënë Zaimina Vasjari.

RITA ORA

na prezanton me të dashurin, shfaqet në krahët e tij

Padyshim që Rita Ora është një nga këngëtarët më të suksesshëm të momentit dhe më e komentuar në media. Shpesh, Rita bëhet kryefjalë e mediave rozë me daljen në publik me të dashurin e saj, ashtu siç ka ndodhur këtë herë. Këngëtarja me origjinë kosovare ka dalë për publikun në krahët e të dashurit të saj të ri, rokeri Andrew Watt. Gjithashtu, këngëtarja ka postuar në "Instastories" foto me të ku shkruan: "skuadra". Ajo duket e lumtur dhe janë kurdo herë pranë njëri - tjetrit, si një çift i lumtur. Kohët e fundit e ftuar në një festë private Rita është parë pranë familjes Kardashian, ku morën shkas shkrimet e ndryshme se do të kishte një rikthim me Rob Kardashian, të cilët kanë pasur një lidhje të bukur para disa vitesh. Rita sapo na tregoi se është e lumtur më të dashurin e ri. Shpresojmë që kjo lidhje të eci mirë.



Opinion i Ditës

Konspiracion kundër muxhahedinëve iranianë

Mga Struan Stevenson

(vijon nga faqja 1)

... iraniane ngre pyetjen se si një regjim, i cili shpesh burgos poetë dhe shkrimtarë ose i detyron ata të ikin në mërgim, papritur rizbulon shpirtin e tij kulturor. Sidoqoftë, në një shqyrtim më të afërt shihet se shumë nga pjesëmarrësit në ceremoni ishin anëtarë të Shoqatës Nejat, një degë e Ministrisë iraniane të Inteligjencës (MOIS), me një mandat të deklaruar për të demonizuar dhe shpërbërë opozitën kryesore demokratike Muxhahedinët e Popullit të Iranit (PMOI ose MEK). Të pranishmit e tjerë në ceremoninë e Teheranit u përshkruan nga mediat shtetërore të Iranit si gazetarë, edukatorë dhe akademikë nga Shqipëria dhe vende të tjera të Ballkanit.

Sipas këtyre raporteve, anëtarët e Shoqatës Nejat dhe familjet e anëtarëve të PMOI në Shqipëri, në një fjalim për pjesëmarrësit shqiptarë në ceremoni, përshkruan "kërcënimet e sigurisë" që paraqit PMOI në "vendet e Ballkanit, veçanërisht në Shqipëri" dhe u ankuan se fëmijët e tyre u mbajtën robër nga PMOI në Shqipëri, duke kërkuar që këta të ashtuquajtur "anëtarë të familjeve" të lejoheshin të vizitonin Shqipërinë për t'u takuar me të dashurit e tyre.

Si ish-deputet dhe kryetar i Delegacionit të Parlamentit Europian për Marrëdhëniet me Irakun, kam ndjekur nga afër çështjen e disidentëve iranianë të PMOI për 15 vitet e fundit, që nga koha kur ishin në kampet Ashraf dhe Liberty në Irak deri në ditët e sotme, ku ata janë zhvendosur për siguri në Shqipëri. Pikat e mëposhtme janë të rëndësishme:

Kryengritja e popullit iranian, e cili filloi në ditët e fundit të vitit 2017, ka përfshirë Teheranin anembanë, duke e detyruar regjimin iranian të kërkojë në mënyrë të dëshpëruar intriga dhe komplete me të cilat të ushtrijë presion mbi PMOI dhe Këshillin Kombëtar të Rezistencës së Iranit (NCRI), të cilin e konsiderojnë si kërcënimin më serioz për pushtetin e tyre dhe e fajësojnë për inkurajimin e kryengritjes. Udhëheqësi suprem Ali Khamenei, Presidenti Hassan Rouhani dhe zyrtarë të tjerë të lartë të regjimit kanë theksuar vazhdimisht se faktori kryesor mbrapa kryengritjes është rrjeti i PMOI-t brenda Iranit.

Një nga makinacionet më të vjetra të bëra nga regjimi në dhjetë vitet e fundit ka qenë dërgimi i "të afërmeve" të supozuar të anëtarëve të PMOI për t'i ngacmuar, abuzuar dhe kërcënuar ata nën maskën e lidhjes së supozuar, me shpresën se kjo t'u shkaktonte torturë psikologjike dhe stres ekstrem. Shumë të afërm të vërtetë të anëtarëve të PMOI janë burgosur në Iran dhe disa janë ekzekutuar, se kontaktuan me fëmijët e tyre të mbyllur me parë në kampet Ashraf & Liberty në Irak. Sidoqoftë, një numër agentësh të Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike



(IRGC) dhe Forcës Quds u angazhuan në mënyrë aktive në këtë formë të torturës psikologjike të banorëve të Kampit Ashraf, duke përdorur 320 altoparlantë njëherësh nga shkurti 2010 deri në dhjetor 2011, për të hedhur abuzime dhe kërcënime ndaj PMOI-t për 24 orë në ditë. Një agjent i mirënjohur i IRGC-së - Ibrahim Khodabandeh - dhe të tjerë që u takuan me të ashtuquajturit 'edukatorë, gazetarë dhe akademikë' të Shqipërisë nën pretekstin e të qenit familjarë të PMOI-t në ceremoninë në Teheran, janë po ata njerëz që morën pjesë në torturën psikologjike të anëtarëve të PMOI-t në kampet Ashraf dhe

Liberty nga viti 2009 në 2016.

Ibrahim Khodabandeh dhe vëlai i tij Massoud dhe kunata e tij, Anne Singleton, janë një bandë e njohur spiunësh që punon për regjimin iranian. Dëshmia në një gjykatë të Britanisë së Madhe e Win Griffiths-it, një anëtare e Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar, e cila udhëtoi në Teheran në vitin 2004, dhe raporti i Qendrës së Kërkimit dhe Mbrojtjes e Kongresit të SHBA-së në dhjetor të vitit 2012 dhe shumë dokumente të tjera shpjegojnë se si këta tre individë u rekrutuan nga MOIS.

Përkujtimi i Naim Frashërit është vetëm një nga komplotet e regjimit iranian kundër PMOI.

Kryengritja e popullit iranian, e cili filloi në ditët e fundit të vitit 2017, ka përfshirë Teheranin anembanë, duke e detyruar regjimin iranian të kërkojë në mënyrë të dëshpëruar intriga dhe komplete me të cilat të ushtrijë presion mbi PMOI dhe Këshillin Kombëtar të Rezistencës së Iranit (NCRI), të cilin e konsiderojnë si kërcënimin më serioz për pushtetin e tyre dhe e fajësojnë për inkurajimin e kryengritjes. Udhëheqësi suprem Ali Khamenei, Presidenti Hassan Rouhani dhe zyrtarë të tjerë të lartë të regjimit kanë theksuar vazhdimisht se faktori kryesor mbrapa kryengritjes është rrjeti i PMOI-t brenda Iranit.

Disa veprime të tjera përfshijnë:

- Emërimin e Gholam Hossein Mohammad Nia, një zyrtar i lartë i Ministrisë së Inteligjencës, si ambasador i Iranit në Shqipëri.

- Dërgimin e Mostafa Roodakit, një nga zyrtarët veteranë të Ministrisë së Inteligjencës, në Shqipëri si Sekretar i Parë i Ambasadës.

- Një rritje të paparë të numrit të stafit të ambasadës, që nuk ka pasur precedent në historinë e të dy vendeve.

- Aktivitetet e dy degëve të Ministrisë së Inteligjencës në Shqipëri me emrat e Qendrës Habilitane dhe Institutit Didban.

- Dërgimin e mullahut Ahmed Hosseini Alast si atashë kulturor në Shqipëri. Ai është përfaqësuesi i Organizatës Islamike për Kulturë dhe Komunikim e lidhur me zyrën e Khameneit.

- Organizimin e takimeve kulturore dhe fetare në Shqipëri nga ambasada e Iranit dhe agjentët e MOIS që kanë për qëllim të vënë vendat kundër PMOI-t.

- Dërgimin e agjentëve të MOIS në Shqipëri si Anne Singleton, e cila udhëtoi në Shqipëri tri herë vetëm në nëntor të 2017.

- Hapjen e faqeve të internetit dhe kanaleve televizive në Shqipëri.

Dhjetëra delegacione nga Parlamenti Europian, parlamentet kombëtare evropiane, Kongresi i SHBA dhe personalitete evropiane dhe amerikane kanë vizituar më parë Kampin Ashraf në Irak. Tani

mbi 3,000 refugjatë të PMOI nga Ashraf dhe Liberty u shpëtuan dhe u zhvendosën në Tiranë në Shqipëri, falë humanizmit të qeverisë shqiptare. Sipas përvojës së të gjithëve që kemi qenë në kontakt të ngushtë me PMOI dhe NCRI dhe presidenten e saj Maryam Rajavi për shumë vite, është një lëvizje rezistence thellësisht demokratike, legjitime dhe e fuqishme, që përfaqëson shtresat e ndryshme të shoqërisë iraniane. Regjimi në Teheran i konsideron ata si kërcënimin e vetëm serioz të tij dhe përveç represionit, torturës, ekzekutimit dhe vrasjes, ka demonizuar dhe shpërndarë informacion të rremë për ta për shumë vite. Shërbimet e inteligjencës evropiane, përfshirë në Gjermani dhe Holandë, Suedi dhe Norvegji kanë dëshmuar se mandati kryesor i MOIS-it jashtë Iranit është të mbledhë informacion kundër PMOI dhe t'i demonizojë ata.

Duke pasur parasysh sa më sipër dhe duke pasur parasysh se regjimi iranian është thellësisht i shqetësuar nga ndërveprimin shumë pozitiv i PMOI me popullin dhe qeverinë shqiptare, qeveria shqiptare duhet të parandalojë masa të tilla nga shërbimet sekrete të regjimit iranian kundër PMOI dhe rekrutimin e disa qytetarëve shqiptarë nga regjimi iranian dhe nuk duhet të lejojë që regjimi teokratik të shqetësojë paqen dhe sigurinë e PMOI në këtë vend.

Opinioni *i* Ditës

Pse nuk përbën më lajm korrupsioni i Edi Ramës?

Nga Astrit Patozi

(vijon nga faqja 1)

... sukseset e veta virtuale dhe çdo akuzë apo fakt e ka për kollaj ta konsiderojë si fjalë apo lloqe kazani. Megjithëse këtë radhë "si-hariqi" vjen nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, e cila për klasifikimin botëror të korrupsionit ka pajtuar Gallup-in, një ikonë e sondazheve në gjithë globin. Sipas testimit, 9 në 10 shqiptarë mendojnë se qeveria e tyre është e korruptuar dhe ky perceptim ka ardhur duke u përqesuar në 5 vjetët e kryeministrimit të Edi Ramës.

I bie që vetëm të stërmoshuar-it, që ngrysin ditët e fundit pa dalë nga shtëpia dhe foshnjat, që nuk kanë shkuar ende në kopsht, nuk e dinë që qeveria u fut përditë dorën në xhepat e tyre për t'i zhvat.

Disa ditë më parë, Shqipëria kishte zbritur 8 shkallë në raportin vjetor të Transparency International, i cili mat indeksin botëror të korrupsionit, por edhe atëherë lajmi kaloi si pa u vënë re, a thua se bëhej fjalë për rënien e çmimit të patateve në Shishtavec. Në fakt, ky është shpjegimi më i mirë i arsyes kryesore se përse njerëzit po largohen masivisht nga Shqipëria, pikërisht në ditën që Edi Rama, pa iu dridhur qerpiku, e konsideroi emigracionin e detyruar nga keqeverisja e tij si një gjë pozitive për vendin. Dhe kur të gjithë presin se çfarë do të thotë për këtë opozita, Lulzim Basha e ka ka gjetur zgjidhjen e kësaj gjendeje të pashpresë tek ndryshimi i datës së përkujtimit të viktimitave të komunizmit, që në



finale zhvlerëson 20 shkurtin, ose më saktë ditën e rrëzimit të shtatorës së Enver Hoxhës në Tiranë. Të cilën, edhe pse më duket një gafë shumë serioze, dëshiroj ta marr pak me të qeshur.

Po mirë mor, Lulzim, nuk të mjafton që ndahemi me PS dhe LSI për datën e Çlirimit të Shqipërisë? Duhet që edhe brenda Partisë Demokratike të kemi patjetër dy

data për të përkujtuar viktimitat e komunizmit? Po socialistët njësoj e kanë çfarëdo propozimi që t'u çosh, se ata nuk kanë ndonjë ndjeshmëri për krimet e diktaturës dhe për simbolat tona.

Madje edhe po i bëre më shumë se dy data, të kënaqur më shumë do të jenë, sepse kjo e bën fare komik të gjithë debatin.

Problemi është të mos fyesh

demokratët dhe të djathtët e tjerë për një çështje, që ka të bëjë me konstitucionin dhe historinë e tyre të vjetër dhe të re.

Por, mbi të gjitha, se duke bërë këtë lloj opozite, sa cinike, aq edhe qesharake, je duke u dhënë të shtyrën e fundit edhe atyre që e kanë ende me dy mendje për të braktisur ose jo përfundimisht Shqipërinë.

HOROSKOPI

DASHI

I keni besuar një personi që e keni njohur së fundmi dhe tashmë jeni të zhgënjyer nga sjellja e tij jo shumë korrekte. Planetët nuk janë të favorshëm ndaj jush. Mos e ndërlironi më tej situatën! Mos e prishni ditën dhe pranoni çdo pasojë!

DEMI

Do t'i ndani idetë tuaja me të tjerët dhe to të metri miratime nga ata që i vlerësoni. Mos u shqetësoni, askush nuk do të ankohet nëse lëni mënjane ndonjë hollësi me pak rëndësi. Miqësi për t'i forcur apo për t'i rizbuluar, ndoshta pas një kontakti fillestar virtual, një takim real.

BINJAKET

Projektet më të rëndësime fillojnë mbarë, për shkak të bashkëveprimit të Mërkurit me Neptunin si dhe mundësisë që keni për t'i shtuar talentet që keni. Nuk keni probleme t'u tregoni të tjerëve se keni të drejtë, ja pse do t'ju ndjekin pa u sforcuar.

GAFORJA

Me pozicionin të favorshëm të Neptunit, të tjerët do ju ndihmojnë në punët e shtëpisë, kështu që do arrini të keni pak kohë të lirë për vete. Jeni gjithmonë të gatshëm të ndihmoni të tjerët dhe asnjeri nuk do refuzojë t'ju japë një ndihmë të vogël, nëse ia kërkon ju.

LUANI

Disa angazhime të rëndësime nuk ju lënë kohë që t'i realizoni ashtu si dëshironi. Fatkeqësisht, megjithatë, askush nuk duket i gatshëm t'ju ndihmojë. Do t'i kryeni detyrat e juaja edhe të vetëm dhe në mënyrën më të mirë të mundshme.

VIRGJERESHA

Pozicionimi i Saturnit ju pengon, por ndërkaq ndërhyrje e Neptunit nuk mund të mos ndodhte në një moment më të mirë, për ju. Do të tejkaloni çdo lloj pengese. Nëse një çështje po ndërlikon ekzistencën prej disa kohësh, tani me në fund gjithçka zhblokohet.

PESHORJA

Planetët do t'ju shtynjë drejt aventurës dhe ndryshimeve të papritura. Por para se të lëni sigurinë dhe pasigurinë, mendohuni dy herë. Disa hapa të ndërmarrja mund t'ju çojnë që të bëni disa zgjedhje të rëndësishme, që do të përfundojnë duke ju ndryshuar jetën.

AKREPI

Energjia e Jupiterit do t'ju nevojitet së tepërmi në botën e sipërmarrjes. Do t'ju ndihmojë gjithashtu të kanalizoni më mirë energjitë e juaja, në mënyrë që të ngriheni. Durimi shpërblehet, por në këtë rast nevojitet mbi të gjitha vullneti, që si doqoftë nuk ju mungon!

SHIGJETARI

Nëse në të kaluarin nuk ia keni dalë të shfrytëzoni të gjithë potencialin e një situatë shumë premtuese, tashmë bashkëveprimi i planetëve do t'ua japin mundësinë. Mos mni duarkyq, sepse tani është momenti që të përsheptoni për të arritur një objektiv të dëshiruar.

BRICJAPI

Për faj të lidhjes midis Marsit dhe Venusit, siguritë tuaja do të dalin se janë kështjella prej rëre, mbi të cilat nuk mund të keni më besim. Është më mirë të ecni me ngadalë për të mos u rëzuar, gjë që nuk mund t'ia lejonit vetes në këto kohë.

UJORI

Shfrytëzoni bashkëveprimin e Diellit me Hënë për të ritur dhuntitë dhe të përdorni çdo mënyrë për të vënë në vijë punët tuaja. Nganjëherë nuk duhet të lodhemi shumë për të rënë në sy, mjafton të zgjidhni me kujdes mundësinë më të mirë.

PESHQIT

Sot do të jeni shumë krijues, të palodhshëm, të aftë për të punuar pa u ndaluar. Nganjëherë, megjithatë, nuk e kuptoni që e tejkaloni masën. Një ofertë pune duket shumë premtuese. Çfarë prisni për ta pranuar? Mos humbni kohë!

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDGJARJA. ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

SITUATË E TURPISHME



U mashtruan nga Vllaznia e Flamurtari, sllovenët trokasën në ambasadë

Flamurtari dhe Vllaznia janë bërë "gazi i botës", teksa nuk kanë shlyer detyrimet e fazës përgatitore në shtetin e Sllovenisë. Në verë 2 klubet shqiptare zgjidhën ta kryenin fazën përgatitore në Slloveni, por me sa duket, nuk i kishin bërë llogarit mirë. Për shkak të mosshly-

erjes së detyrimeve, kompania "B4Sport" i ka dërguar një shkresë ambasadës shqiptare në Slloveni. Drejtoi i kompanisë, Zinka Peterlin, i ka kërkuar ndihmë ambasadorit Pëllumb Qazimi në lidhje me situatën që kanë me Flamurtarin dhe Vllazninë. Shkodranët i detyrohen

kompanisë "B4Sport" 1600 euro. Para 2 vitesh, shkodranët kanë kryer fazën përgatitore në Slloveni dhe sipas asaj që raportohet në shkresë, nuk kanë shlyer detyrimet financiare për 4 ndeshje miqësore që janë organizuar në atë periudhë, për pagesën e arbitrave etj. Ndërsa vlonjatët

plot 30 mijë euro. Nga ana tjetër, Flamurtari akuzohet se ka një borxh prej 2600 eurosh, ku përfshihen 5 ndeshje miqësore dhe akomodimi në "Hotel Dravograd", gjatë fazës përgatitore të zhvilluar në Slloveni. Si të mos mjaftonin problemet e shumta financiare me shlyerjen e lojtarëve dhe me llogaritë e bllokuara bankare, klubet shqiptare kanë edhe një njollë në shtetin slloven.

Grumbullohet për herë të parë Kristal Abazaj, Enis Gavazaj, Bujar Lika dhe Herdi Prenga



Jeton Selimi

Shpallet lista e trajnerit Kristian Panuçi për lojtarët e grumbulluar për miqësoren me Norvegjinë, që luhet më 26 mars. Bien në sy në këtë listë emrat e Kristal Abazajt të Luftëtarit dhe Enis Gavazajt të Skënderbeut, por edhe emra të tjerë si Herdi Prenga dhe Bujar Lika, i pari luan me Inter Zapresic në Kroaci dhe i dyti me Grasshoppersin në Zvicër. Të dy emrat e fundit luajnë në mbrojtje. Konfirmohet thirrja e Ylber Ramadani, mesfushorit që luan në Danimarkë. Janë lënë jashtë emra si Migjen Basha, Azdren Llullaku dhe Ergys Kaçe, për të cilët trajneri Panuçi do të japë shpjegime të hënën. Po ashtu, për shkak të dëmtimit nuk janë thirrur Veseli dhe Abrashi. Memushaj është ndëshkuar me karton të kuq në miqësoren e fundit me Turqinë. Ja dhe njoftimi i FSHF-së në lidhje me listën e Panuçit: "Sikundër është bërë tashmë traditë, tekniku publikon listën me lojtarët disa ditë përpara, teksa në pas për të gjithë gazetaret do të ketë daljen e tij publike në një konferencë për shtyp, ditën e hënën në orën 11.00 në FSHF. Në listën e trajnerit për këtë ndeshje shikohen edhe grumbullimet e disa lojtarëve të rinj, që vijnë për herë të parë në këtë skuadrën kombëtare të futbollit, në një kohë që një pjesë tjetër mungojnë edhe për efekt dëmtimi. Grumbullimi i skuadrës përfaqësuese do të nisë të hënën në datë 19 mars,

Kristian Panuçi dhe lista e tij e çudirave

Thërret Andi Lilën, por lë jashtë Agollin & Co!



në resort 'Tropikal' në Durrës. Ditën e hënë do të bëhet publik edhe programi i plotë mediatik dhe stërvitor për ekipin kombëtar të futbollit për të gjithë javën e grumbullimit". **ABAZAJ** Futbollisti i Luftëtarit, Kristal Abazaj, mori një ftesë nga trajneri i Kombëtares për të qenë pjesë e skuadrës për ndeshjen miqësore ndaj Norvegjisë. Forma e shkëlqyer e 21-vjeçarit në Kategorinë Superiore e ka bindur teknikun italian që t'i japë shansin Aba-

zajt për të veshur fanellën e Kombëtares A. Mesa duket, goli i shënuar ndaj Kukësit ka qenë vendimtar dhe ka vendosur vullën për afrimin e Abazajt. Ditën e sotme, klubi i Luftëtarit ka bërë publike e ftesën të mbërritur në klubin gjirokastrit në lidhje me përzgjedhjen e Abazajt për të qenë pjesë e Kombëtares dhe ai të lihet i lirë nga data 19 deri 27 mars. **LIKA** Mesfushori 25-vjeçar, Bujar Lika është surpriza me e

madhe e trajnerit Kristian Panuçi, në listën e grumbulluar për sfidën miqësore ndaj Norvegjisë, që do të luhet në datën 26 mars në stadiumin "Elbasan Arena". Po kush është Bujar Lika? Ai ka lindur në Zvicër dhe është pjesë e klubit zviceran Grasshoppers, që prej 8 janarit të vitit 2018. Lika është 1.77 metra i gjatë dhe ai mund të luajë në dy role, si mesfushor qendror dhe mesfushor i krahut të djathtë. Përpara transferimit të Grasshoppers, shqiptari ka

qenë pjesë e Shafhausen, Uohlen dhe Luzern U-21. Në 5 ndeshje në Superligën zvicerane, ai ka shënuar 1 gol, atë ndaj Luzernit, në 11 shkurt të këtij viti. Lika shihet si një futbollist tepër premtues në repartin e mesfushës, ndaj edhe trajneri i Kombëtares shqiptare ka menduar t'i japë një shans për ta pasur pjesë të skuadrës.

PRENGA

Trajneri i Kombëtares shqiptare, Kristian Panuçi, ka ftuar disa emra të rinj në Kombëtare për miqësoren ndaj Norvegjisë. Njëri ndër ta është edhe mbrojtësi Herdi Prenga, i cili luan në Kroaci me ekipin e Inter Zapresic. Mbrojtësi është një lojtar i rritur në akademinë e Dinamos së Zagrebit dhe ka luajtur me ekipet e moshave të Kroacisë deri te Shpresat e tyre, por si përfundim ai zgjodhi të përfaqësonte Shqipërinë. 23-vjeçari ka luajtur 8 ndeshje me Shpresat e Shqipërisë dhe ka shënuar një gol vendimtar, atë të fitores 2-1 ndaj Hungarisë U-21. Prenga është gati të bëjë hapin e madh në Kombëtaren A të Shqipërisë.

SHKURT

Toti: Barcelona do djersijë ndaj Romës

Francesco Toti, drejtues i Romës, ka komentuar shortin "e pamëshirshëm" të çerekfinaleve të Championsit, që e vë skuadrën e tij përballë Barcelonës: "Jam i kënaqur, sepse jemi mes tetë skuadrave më të forta të Europës. Janë të gjitha të vështira dhe do ta përballojmë Barcelonën me qetësi. E dimë që Barcelona është ndër skuadrat më të forta në Europë, por dimë edhe që mund të bëjmë mirë ndaj saj. Dolëm të parët në një grup shumë të vështirë, kaluam Shakhtarin në 1/8 dhe me siguri Barcelona do të djersijë fort për të mposhtur Romën".

Klop: Siti nuk e donte Liverpoolin përballë

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klop, është ndalur të flasë për shortin e Ligës së Kampioneve, ku goglat vendosën që ekipi i tij të përballë me Manchester Sitin në fazën çerekfinale. "Në të gjitha ndeshjet që kemi bërë deri sot, kemi marrë aq sa kemi dhënë, prandaj edhe këtë herë besoj se do të jetë ashtu. Kundërshtar kemi Sitin dhe le të luajmë kundër Silit, pasi nuk ka asnjë problem. E di që Liverpooli nuk është kundërshtari që ata donin, por ky ishte shorti".

LIGA E KAMPIONEVE

Pas përcaktimit të 8 skuadrave çerekfinaliste të Ligës së Kampioneve, e gjithë vëmendja shkon te shorti që u hodh në Nion të Zvicrës. Shorti ka rezervuar një përballje të frikshme italo-spanjolle, atë mes finalistëve të sezonit të shkuar, Real Madrid dhe Juventus.

Përplasja italo-spanjolle në çerekfinale

BARCELONA	V	ROMA
SEVILLA	V	BAYERN
JUVENTUS	V	REAL MADRID
LIVERPOOL	V	MAN. CITY

janë treguar bujare për skuadrën e Barcelonës dhe Bajernit. Spanjollët e Valverdes do të ndeshen me italianët e Romës, ndërsa Bajerni do të ketë përballë Sevillën e Montelës. Takimet e para çerekfinale janë përcaktuar të zhvillohen në datat 3 dhe 4 prill, ndërsa ato të kthimit në 10 dhe 11 prill.

REAGIME PËR SHORTIN


Njëri nga drejtuesit kryesorë të Realit të Madridit, Emilio Butragenjo, për përplasjen me Juventusin në çerekfinale të Champions League, u shpreh: "Juventus është një skuadër e madhe dhe e tregoi këtë jo më larg se pak ditë më parë, kur

Butragenjo: Me Juventus do të kemi probleme



eliminon Tottenhamin. Ia arritën qëllimit të kalonin vështirësitë dhe të kualifikoheshin. Mendësia e Juventusit është e tillë dhe mendoj se do të jetë një garë e ekuilibruar. Jam i bindur se do të na krijojnë probleme. Duhet të jemi në nivelin e duhur, duhet Real më i mirë për të kaluar Juventusin".

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

2. Gjëja e latinëve.
5. Ai i Kuq u hap për hebrejtë.
9. Eshhtë fjala e për e foshnjës.
11. Ministri Ekonomisë e Punë
13. Marubi i fotografisë.
14. Bel i Mapupassant.
15. Bëhet duke tregtuar objekte të shenjtë.
18. Derek aktore.
19. Gjysmë totale.
20. Eshhtë art i të folurit
22. Një patriark biblik.
24. Mund të jenë zemërkau të tilla.
26. Janë dëshmorë të kishës.
28. Eshhtë lloj papagalli.
29. Eshhtë lloj papagalli.
30. Qerre pa qe.
32. Ekstreme në numërim.

33. Eshhtë bodrumi.
34. Steiger aktor.
35. Inicialet e Delon.
37. Eshhtë edhe ai Me Gropa.
38. Një mund të jetë autonom.
40. Në krye yë evidencës.
42. Edgar Allan Poe.
44. Ekstremet në litar.
46. Giorgio i modës.
50. Janë malet me Akonkagua.
52. Janë ujërat e bregdetit tonë.

VERTIKAL

1. Novarro që qe aktor.
3. Kusturica regjisor.
4. Eshhtë e jashtëzakonshme.
6. Inicialet e Kazan.
7. Ishte qyteti i 100 portave.
8. Pinci i Dy herë mat.
9. Janë të mirat që prodhohen.
10. Eshhtë ai që gënjën për t'u bërë i njohur.
11. Një markë celulari.
12. Ushtrohej nga filibustierët.
16. Një përsiatje.
17. Agjenci Informative Tiranë.
21. Një brejtës pylli.
23. Një Gjon që qe aktor i yni.
25. Titulli i Byron.
27. Në radhë të parë.
31. Emri i Amundsen.
36. Moore aktore.
39. Pishtarë pa pishë.
41. Gjysmë vatani.
43. Rruga e Molnar.
45. Një fazë gjumi.
47. Inicialet e Redford.
48. Në krye të notarëve.
49. Inicialet e Reitman.
51. Unë dhe ti.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Nuk kalohet nga mbetësi.
5. U printe gladiatorëve
12. Bëhet duke shkuar lart e më lart
14. Tatum që qe pianist.
15. Një që lufton për para
16. Mund të bëhet me safari
17. Breshkat luftarake të kartonave
19. Ngjitet kur nuk nget
20. Në mes të rrugës
21. Sporti me rikisha
25. U shkrua nga Hesiodi
26. Një sferë për model
27. Mbyllin një sirtar
28. Makina Tipo
30. Inicialet e Bean, aktor
31. Nino, kompozitor i famshëm italian
33. Ramiro pa zë.
34. Neill i Jurassic park.

VERTIKAL


2. Ishin grekët në trojë
3. Ishin paiate të beut
4. Goodëin, ndihmësi i Nero Wolfe
5. Pak sinqeritet
6. Personazhet e Charles Schulz.
7. Kompozoi Mefistofele
8. Në radhë të parë.
9. Qytet zviceran
10. Në krye të kryesisë
11. Ughi violinist
13. Carlos që qe pilot i Formula 1
15. Ekstreme në muzg
18. Inicialet e Steinbeck
22. Gruda, "Njeriu me top"
23. Eshhtë X ajo e sulmit
24. Paradhoma e parajasës
28. Eshhtë edhe ai i lufës
29. Janë edhe ato të cirkut
31. Mbarojnë fare
32. Inicialet e Reed, aktor
34. Të parët në sondazh
36. Eshhtë taksa
38. Një mund të jetë emërоре
39. Një pjesë e marrëzisë
41. Gjysmë mimoze
42. Hundë kur s'jam unë
43. Skuadër greke
44. Lempër, këngëtare gjermane
46. Fundi i një akti



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

5	2			9			3	4
6		4				8		1
		9	1		8	3		
8								5
		2	5		9	6		
9		5				4		7
2	1			3			6	9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

6	8	7	4	5	1	9	3	2
4	3	9	8	2	6	7	1	5
5	2	1	9	3	7	4	6	8
2	4	6	1	8	3	5	7	9
7	9	5	6	4	2	1	8	3
3	1	8	7	9	5	2	4	6
8	7	2	5	6	4	3	9	1
1	6	3	2	7	9	8	5	4
9	5	4	3	1	8	6	2	7

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj rreziqeve do të kultivojë forcën e regjimit ndaj tyre. (Seneka)
- Arti i krijimit është më i vjetër se sa arti i vrasjes. (Andrej Voznjzenski)
- Asnjë artist nuk ec para kohës së tij. Ai është vetë koha e tij. Vetëm se të tjerët janë prapa kësaj kohe. (Marta Grehem)

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

17	1	8	4	2	4	13	1	13	1	M	I	K	E	K	M	S	E					
18	3	1	4	18	3	17	13	1	1	E	K	A	R	O	M	A	K	E	T			
8	1	10	10	10	1	3	1	6	12	6	K	M	I	L	I	T	A	N	T	E	T	
3	1	10	2	3	6	14	1	12	2	4	M	A	T	E	M	A	T	I	K	A		
15	9	6	15	1	12	4	6	6	3	3	P	A	S	A	N	I	K	T	S			
17	2	4	5	12	2	14	17	5	1	4	E	K	U	A	N	E	T	A	R	E	T	
8	1	7	6	3	1	10	1	1	1	2	R	E	T	E	E	I	R	A	N	I		
15	5	12	4	6	4	18	7	7	1	3	I	T	R	B	L	A	K	E	L			
1	3	2	8	1	5	2	12	2	2	M	I	A	R	E	D	E	K	I				
20	19	1	3	20	5	4	6	10	2	4	E	M	E	T	A	L	E	I	S			
1	1	10	2	3	2	12	15	18	2	8	T	E	K	E	M	K	U	M	T			
											M	O	R	A	V	I	A	M	A	E		

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

A	R	K	A	A	S	T	R	O	A	M	A	
D	I	A	N	A	H	A	N	T	I	K		
A	T	L	A	N	T	I	K	E	O	L	S	
P	E	I	T	A	R	I	F	A	T	L	E	
T	T	P	O	L	I	T	I	K	A	N	E	T
K	E	N	E	T	A	O	R	A	R	T		
P	A	U	L	I	N	R	R	I				
K	E	O	T	A	A	D	D	I	M			
R	U	M	U	N	E	K	N	I	E	R	A	
E	T	I	T	E	R	I	A	M	A	N		
T	E	I	G	O	R	D	I	A	N	E		
I	N	T	A	R	O	M	A	T	I	T		

FJALËKRYQI (2)

P	A	B	M	E	L	E	R	G	O			
A	K	K	U	P	A	E	M	I	R	A	T	E
O	H	A	R	A	D	A	R	O	M	A	T	
C	I	K	L	I	S	T	E	T				
S	T	A	D	I	U	M	E	T	A	P	E	L
D	I	K	A	S	T	E	R	E	R	U	E	
K	E	N	T	N	G	O	P	J	E	V		
K	A	T	I	A	S	I	E	S	E			
M	A	R	S	N	I	O	L	A	T	R		
A	M	S	S	I	M	O	Z	A	N	O	R	E
A	M	A	N	A	N	A	N	N				
T	T	E	R	R	E	N	T	E	I	N	E	



Thënie të mënçura

- Dua gjithmonë të di çdo gjë mbi miqtë e mi të rinj dhe asgjë mbi ata të vjetrit. Oscar Wilde (1854 - 1900)
- Miqtë kanë të gjitha gjërat e përbashkëta. Platoni (427 BC - 347 BC), Dialogues, Phaedrus
- Një ditë e shpenzuar mirë, sjell gjumë lumturie.
- Nuk ka asgjë në botë që të garmatosë më shumë e më fort sesa mendimi që përmban mirësi...
- Mirënjohja është një barrë, dhe çdo barrë është bërë për t'u çliuar prej saj. Denis Diderot

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL



- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al



Tashmë edhe lundroni!

